



SHKOLLA LETRARE E FRANÇESKANËVE

(Konstanta, autorë e vepra)

KUJTIM M. SHALA

I. FRANÇESKANËT SHQIPTARË / SHKOLLA LETRARE

Urdhri françeskan mbahet me vetitë universale të përkorjes e të shërbimit. Është urdhër i njerëzve të përvujtur e të besës.

Françeskanët shqiptarë u tretën duke i shërbyer me përvujtni besës e jetës shqiptare. Ndaj, përpos që përmbushi detyrën e besës, Urdhri françeskan, ndër shqiptarë, u rrit në model kulturor, letrar e arsimor.

Autorët françeskanë gjurmuan jetën e trashëgiminë shqiptare, për të zbuluar vetitë etnike tejkohore. Ata zbuluan shqiptarin, ashpërsinë e ndjeshmërinë e tij, moralin, burrin e besës e hokatarin, gjaknxehtin e të drejtin.

Mblodhën, studiuuan e botuan trashëgiminë gojore. Shkruan sipas e në modelet popullore dhe në gjuhën e gjallë. Shkruan shqipen, idiomën, siç buronte nga goja e njerëzve, por edhe e sprovuan më tej. Përkthyen e përshtaten në gjuhën shqipe vepra e kryevepra. Nxorën revistat e njohura letrare e kulturore, si *Hylli i Dritës*. Themeluan e mbajtën shkollat shqipe të besës e të dijes. Dhanë autorin më të madh të shekullit, Atë Gjergj Fishtën, por edhe njeriun që dëshmoi për vuajtjen e egërsinë, Atë Zef Pllumin.

Këto janë nyja të misionit të françeskanëve shqiptarë. T'i rikujtojmë me emra disa prej tyre: Leonardo de Martino, Gjergj Fishta, Shtjefën Gjeçovi, Bernardin Palaj, Donat Kurti, Vinçenc Prennushi, Marin Sirdani, Anton Harapi, Justin Rrota, Zef Pllumi etj., vëllezërit e vegjël të Shën Françeskut, etërit e mëdhenj shqiptarë.

Formulimi *Shkolla letrare e françeskajvet* ka autor Ernest Koliqin. Ai,



siç dihet, bëri tipologjinë e dy shkollave (rrymave) letrare shkodrane, gege; *e jezuitvet* dhe *e françeskajvet*, duke pasur kriter *tema e stile*. *Shkolla letrare e jezuitvet* buron nga literatura, qoftë në planin e temave, qoftë në atë të stilit.

Ndërsa, *Shkolla letrare e françeskajvet* është idiomatike, me tema të lidhura me një ambient dhe me jetën e traditën e tij. E thënë ndryshe, kjo është shkolla tradicionale, autentike shqipe.

/vijon në faqen 6/

JAVA E BIBLIOTEKËS NË KOSOVË 2009

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës dhe Ambasada Amerikane në Prishtinë, organizojnë nga data 14 deri më 18 prill Edicionin e shtatë - Java e Bibliotekës në Kosovë 2009.

Ky manifestim për Librin dhe Bibliotekat do të mbahet në Prishtinë, Gjakovë dhe Ferizaj dhe përfshin aktivitete të rëndësishme kulturore: seminare, ligjërata speciale, ekspozita, promovime.

Java do të hapet me filmin dokumentar “Biografia e Obamas”, kush-tuar presidentit të parë afro-amerikan të SHBA-ve, Barack Obama, ndërsa do të dhurohen nga Ambasada Amerikane në Prishtinë ekzemplarë nga libri i tij “Guximi për të shpresuar”.

Gjatë Javës së Bibliotekës do të nënshkruhet Akti i Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës dhe Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë për shkëmbimin e periodikut Kosovë - Shqipëri

Në Javën e Bibliotekës në Kosovë do të marrë pjesë Dr. Kenneth Oberembt, specialist për zhvillimin e bibliotekave nga SHBA, i cili mbahet në mend në Kosovë si drejtor i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, që hartoi Planin



strategjik për të ardhmen e Bibliotekës Kombëtare dhe Bibliotekës Universitare të Kosovës.

Gjatë kësaj Jave, organizohet Dita e Dhurimit të Librit, si dhe do të mbahen debate e diskutime për projektet e të ardhmes së bibliotekave në Kosovë.

Në Javën e Bibliotekës në Kosovë marrin pjesë përfaqësues të njohur të kulturës e të politikës nga Kosova, Shqipëria dhe vende të ndryshme evropiane.

Java e Bibliotekës në Kosovë është ngjarja më e rëndësishme e vitit për kulturën dhe bibliotekat në Kosovë.

Në këtë numër



HISTORIA GOJORE DHE KUJTESA E KOSOVËS16

KLASIFIKIMI I BIBLIOTEKAVE DHE KLASIFIKIMI NË BIBLIOTEKA.....18

HARTOGRAFIA DHE HARTAT20

BIBLIOTEKA - KOLEKSIONET MUZIKORE DHE PËRDORUESIT.....22

RËNDËSIA E MBROJTJES SË MATERIALIT BIBLIOTEKAR ..24

KULTURA, BIBLIOTEKA, MEDIA28



www.biblioteka-ks.org

Botues: BKUK • **Kryeredaktor i botimeve:** Prof. dr. Sali Bashota

Kryeredaktor: Fazli Gajraku

Këshilli redaktues: Besim Kokollari, Bukurije Haliti

Realizimi kompjuterik: Hekuran Rexhepi

Adresa: Sheshi “Hasan Prishtina”, p.n. Prishtinë

Tel: ++381 38 225-605, **Fax:** ++381 38 248-940 • **e-mail:** biblioteka@biblioteka-ks.org

U ORGANIZUA NË TIRANË EDICIONI III I KONFERENCËS KOMBËTARE TË BIBLIOTEKONOMISË

Tiranë, 20 - 22 nëntor 2008

Në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë, nga 20 - 22 nëntor 2008, është organizuar Konferenca Kombëtare e Bibliotekonomisë me titull: "Biblioteka urë mes dijes dhe publikut".

Kjo Konferencë tashmë tradicionale - e përvitshme, e cila vitin e kaluar është mbajtur në Prishtinë, është themeluar në vitin 2006, si rezultat i një marrëveshjeje të bashkëpunimit mes Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës dhe Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë.

Konferenca Kombëtare e Bibliotekonomisë është manifestim i përbashkët i këtyre dy institucioneve më të rëndësishme (të Kosovës dhe të Shqipërisë) dhe mbledhet nën kujdesin dhe mbështetjen e institucioneve qeveritare të Republikës së Kosovës dhe të Republikës së Shqipërisë.

Në këtë Konferencë, janë paraqitur 22 përfaqësues të dijeve nga fusha e bibliotekonomisë - autoritete që drejtojnë dhe menaxhojnë bibliotekat kombëtare, universitare, publike etj. nga Shqipëria dhe Kosova, si dhe specialistë të bibliotekonomisë nga të dyja vendet, të cilët kanë trajtuar probleme të rëndësishme nga zhvillimet më të reja në fushën e bibliotekonomisë, që lidhen me relacionin midis publikut dhe dijes në kontekstin aktual dhe atë të perspektivës.

Në Edicionin e Tretë të Konferencës, janë organizuar edhe aktivitete të tjera me përmbajtje dhe interes në fushën e zhvillimeve bashkëkohore të bibliotekonomisë

Konferenca është hapur nga Dr. Aurel Plasari, drejtor i Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, dhe Sali



Pamje nga hapja solemne e Edicionit III të Konferencës Kombëtare të Bibliotekonomisë

Bashota, drejtor i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, bashkëthemelues të kësaj konference, të cilët, pasi kanë përshëndetur të fuqarit dhe pjesëmarrësit, kanë vënë në dukje rëndësinë dhe kontributet e një veprimtarie të tillë në zhvillimin e bibliotekave shqiptare si dhe në përballimin e sfidave në të ardhmen në punën mes dijes dhe përdoruesve. Konferenca është përshëndetur edhe znj. Zana Turku, zëvendësministre e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe z. Gazmend Pula, ambasador i Republikës së Kosovës në Shqipëri.

Specialistë dhe ekspertë të bibliotekave kanë paraqitur kumtesa, në të cilat janë analizuar praktikat, por dhe vizionet e përbashkëta për rolin që kanë bibliotekat në epokën digjitale - si ura ndërmjet publikut dhe dijes. Janë trajtuar probleme të ndryshme të praktikës dhe të teorisë bibliotekare që

kanë të bëjnë me shërbimin e referencave, sfidat që janë duke u paraqitur gjatë procesit të digjitalizimit të koleksioneve në bibliotekat kombëtare të të dy vendeve, relacionet midis bibliotekës dhe internetit në kërkimin e avancuar etj.

Një varg temash, gjatë sesioneve ishin fokusuar, në evidentimin e rolit ndërmjetës të bibliotekave midis dijes që ofrojnë koleksionet bibliotekare dhe përdoruesve që i përdorin ato.

Konferenca Kombëtare e Bibliotekonomisë, e cila u mbajt në Tiranë edhe një herë rikonfirmoi nevojën për të hapur debate të përbashkëta dhe për të dhënë rrugët nga duhet orientuar politikat profesionale në epokën e digjitalizimit të bibliotekave, në këtë kontekst edhe të problemeve që dalin gjatë këtij procesi në të cilin tashmë janë hyrë edhe bibliotekat në Shqipëri dhe në Kosovë.

DORËSHKRIMET ARABE NË KOSOVË

Në koleksionet e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës fondi i dorëshkrimeve orientale në gjuhën arabe, persiane, osmane dhe shqipe me shkronja arabe, gjithsesi, përbën një thesar të çmueshëm dhe me vlera të veçanta dhe ky koleksion numëron 728 vëllime me afro 1300 vepra, ndërkaq në përgjithësi në Kosovë janë evidentuar mbi 3000 dorëshkrime orientale.


Pasurimi me llojin e këtyre dorëshkrimeve në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, si dhe në shumë institute, arkiva, muzeume, medrese, teqe, familje etj., në shtetin e Kosovës, dëshmon për rëndësinë që e kanë këto dorëshkrime, pikërisht me përmbajtjen e tyre gjuhësore, fetare, historike, kulturore etj.

Pra, dorëshkrimet arabe në Kosovë dëshmojnë edhe për kujdesin dhe dashurinë e ruajtjes së tyre edhe në rrjedhat e historisë së kohëve dhe rrethanave të ndryshme politike e shoqërore, ku bibliotekat iu kanë nënshtruar asgjësimit dhe djegies së fondeve të tyre.

Vlera dhe rëndësia e dorëshkrimeve arabe në Kosovë, të cilat janë ruajtur në një shoqëri me qytetërim tradicional, tashmë është shumë domethënëse, pikërisht përbrenda hapësirave të komunikimit kulturor ndërkombëtar.

Duke i ndriçuar në rrafshet e hulumtimit, interpretimit, studimit shkencor dorëshkrimet e shumta arabe në Kosovë, madje me shumëllajshmërinë dhe lashtësinë e tyre, ato paraqesin vlera universale për qytetërimin dhe për njerëzimin në përgjithësi.

Dorëshkrimet arabe në Kosovë-të rralla, të vjetra e të veçanta- janë një trashëgimi kulturore dhe një pasuri intelektuale, që e shënojnë kohën, vendin, ekzistencën e tyre në periudha të hershme.



BIBLIOTEKA
KOMBËTARE DHE
UNIVERSITARE
E KOSOVËS

THE NATIONAL
AND UNIVERSITY
LIBRARY
OF KOSOVA

Katalog Dorëshkrime Arabe në Kosovë

فهرس
مخطوطات العربية في كوسوفا



Prishtinë

2008

پریشینا

Fundja, mbijetesa e dorëshkrimeve në të kaluarën, si dhe lashtësia dhe origjinaliteti i tyre, bëhen burim i informacionit dhe i diturisë në të ardhmen.

*Prof. dr. Sali Bashota,
Drejtor i Bibliotekës Kombëtare dhe
Universitare të Kosovës*

VLERA KULTURORE DHE HISTORIKE E DORËSHKRIMEVE ARABE NË KOSOVË

Fondit të trashëgimisë kulturore shqiptare dhe botërore po i shtohet edhe një vepër me vlera të larta kulturore, historike etj., Katalogu Dorëshkrime arabe në Kosovë. Lexuesi shqiptar dhe ai arab tani kanë rastin të komunikojnë për herë të parë me një vepër të këtij lloji. Vëllimi Dorëshkrime arabe në Kosovë është me interes të veçantë, sepse synon t'i paraqesë opinionit shqiptarë si dhe atij arab, vlerat më të ndritura të historisë së kulturës dhe të qytetërimit të për-bashkët që kanë krijuar këta popuj që prej kohësh. Dorëshkrimet e përfshira në këtë vëllim, sipas të dhënave që na japin ato, janë përshkruar a kopjuar jo vetëm nga autorë të njohur arabë, turq, persianë, por edhe nga autorë vendas, shqiptarë. Dhe, të përshkruarit a të kopjuarit e këtyre dorëshkrimeve, interesimi për to, ruajtja e tyre me një fanatizëm dhe vetëdije të lartë, bartja e tyre nga brezi në brez është, pa dyshim, një nga kontributet e mëdha të popullit shqiptar.

Një vlerë tjetër që do theksuar në këtë rast lidhur me dorëshkrimet e përfshira në këtë vëllim është dhe fakti se në mesin e tyre ka të tilla dorëshkrime të cilat datojnë që nga shekulli XIII-të.

Këto vepra kanë qenë pronë e shkollave, medreseve, xhamive, teqeve, ku kishte gjithnjë njerëz të ditur e të shkolluar. Ata që i kishin në dorë këto vepra, si: mualimë (mësues), hoxhallarë, shehlerë etj. i lexonin, i interpretonin, i për-kthenin ose i përshkruanin vetë, dhe,

së fundi, kujdeseshin për t'i lënë në duar të sigurta, me qëllim që të mos zhdukeshin.

Në fondin e përgjithshëm të dorëshkrimeve orientale në Kosovë, sipas shënimeve të institucioneve relevante, ka vepra origjinale kush-tuar Kur'anit Famllartë, interpretimeve të Kuranit, fushës së Hadithit dhe jurisprudencës islame; vepra të gjuhësisë dhe të letërsisë arabe, turke, persiane; vepra në fushën e shkencave shoqërore; vepra mjekësore; vepra të shkencave natyrore etj. Të gjitha këto vlera përfshijnë një numër të konsiderueshëm, me mbi 3000 dorëshkrime.

Këto vepra dorëshkrimore janë kopjuar me kaligrafinë e pasur arabe, varësisht nga shija dhe afiniteti i kopjuesit. Përveç kësaj, për t'u bërë vepra sa më artistike, gjatë përshkrimit të sajë, sipas asaj që shihet, janë përdorur në vende të duhura edhe ilustrime e zbukurime të llojllojshme.

Kjo pasuri dokumentare me vlera të shumanshme kulturore, historike, fetare, shkencore etj., mjerisht, qe lënë pas dore. Mospërfillja dhe shmangia nga ky thesar kulturor, mendoj se është një e padrejtë e madhe.

Mirëpo, tani Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, Biblioteka Qendrore e Dorëshkrimeve Islame pranë Medresesë së Mesme "Alauddin" në Prishtinë, Arkivi i Kosovës, Biblioteka e Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve në Prizren, Biblioteka e Teqesë së Sheh Musasë e

tarikatit Rufai, Biblioteka e Teqesë së Sheh Eminit e tarikatit Saadi në Gjakovë si dhe institucionet e tjera kulturore dhe shkencore në Kosovë, ofrojnë bashkëpunim, respekt dhe frymë konstruktive për studimin e dorëshkrimeve të kësaj natyre në mënyrë që të ndriçohet dhe të vihet në komunikim publik kjo pasuri me vlerat e veta përmbajtjesore.

Vëllimi Katalog i dorëshkrimeve arabe në Kosovë, i përbërë prej 50 njësive ka këtë shtrirje tematike e kronologjike:

- Kur'an dhe shkenca kuranore,
- Hadhith dhe sire (biografi),
- Fikh dhe jurisprudencë islame,
- Akaid, filozofi, tesavuf,
- Gjuhësi dhe letërsi arabe,
- Shkenca shoqërore,
- Shkenca natyrore dhe mjekësi.

Çdo dorëshkrim i përfshirë në këtë vëllim përmban: emrin e autorit, titullin e veprës, kopjuesin dhe vitin e kopjimit. Këto shënime nuk figurojnë të plota vetëm aty ku përgatitësit e veprës nuk i kanë gjetur të gjitha të dhënat e nevojshme në dorëshkrimin përkatës.

Vëllimi Katalogu i dorëshkrimeve arabe në Kosovë përfshin materialin e përzgjedhur të dorëshkrimeve arabe nga shek. XIII-XVIII.

Me këtë rast, të gjithë atyreve që ndihmuan në realizimin e këtij projekti të rëndësishëm, kemi kënaqësinë t'u shprehim mirënjohjet dhe falënderimet tona më të sinqerta.

*Prishtinë, 2.12.2008,
Prof. dr. Ismail Ahmedi*

SHKOLLA LETRARE E FRANÇESKANËVE

/vijon nga ballina/

Shkolla letrare e jezuitvet, po në tipologjinë e Koliqit, ka autor themelor Mjedjen; ajo e *françeskajvet* - Fishtë. Koliqi s'harron të nënvizojë dallimet relative ndërmjet këtyre shkollave. Të rikujtojmë, vetë Koliqi, në veprën e tij, bën bashkë Fishtën e Mjedjen (kemi parasysh për relacionin me të parin *Hija e Maleve*, ndërsa me të dytin *Pasqyrat e Narçizit*). Në të vërtetë, sa i takon shkollës letrare të jezuitëve, duket që Koliqi ka kriter themelor tipologjizues *stilin*.

Kulturalisht, shkolla e françeskanëve është e krishterë. Në këtë tipologji, *urdhri* bëhet përcaktues kulturor i autorëve, por jo edhe përcaktues letrar, meqë *tema e stili* janë esenca letrare.

Temat e autorëve françeskanë burojnë nga tradita dhe jeta e gjallë e shqiptarëve. Këtyre u shtohen temat nga historia e rendit françeskan dhe temat e sivëllezërve shqiptarë në shërbim të *urdhrit*. Gjithsesi, temat e françeskanëve i takojnë binomit *Atmé e Fe*.

Temat përputhen me diskutet (gjuhën burrnore), ndaj temat ambientale të françeskanëve thuren në diskurs idomatik, në shqipen e gjallë të Veriut (malësi e qytet), në gegnishte.

Heronjtë e autorëve françeskanë janë ambientale, po aq heronj të traditës gojore shqiptare. Të rikujtojmë këtu heronjtë e Fishtës: Oso Kuka, Marash Uci, Dedë Gjo Luli etj. Gjithsesi, figura historike, para e të kohës së Fishtës. Por, Fishta, siç e do literatura, secilin reagens e univesalizon, meqë lakmon e

univesalizon situatat. Modele letrare të reagensave bëhen modelet e letërsisë gojore, sidomos nga Kângët kreshnike.

Për të qenë pamja më e plotë, duhet të kujtohet përherë Patër Gjoni i *Labutës së Malcís*, frati i urtë, i përvuajtur e atdhetar. *Atmé e Fe*, pa dyshim; një binom me dy faqe. Vërtet, njëra nuk bën pa tjetrën. Kemi theksuar më parë dhe mbrojmë sot, përkundër keqkuptimeve, që *Labuta e Malcís* është ep i krishterë, prandaj ep nacional.

Përfundimisht, temat, stili, lidhja me letërsinë e kulturën gojore dhe me jetën e gjallë e bëjnë shkollën letrare të françeskanëve disi më popullore.

II. AUTORË E VEPRA

Në vijim, marrim autorë e vepra me gjuhën e evidencës e të karakterizimit, për t'i provuar disa nga shenjat e shkollës letrare e kulturore të françeskanëve.

Leonardo de Martino, frati italo-arbëresh, është themeluesi i shkollës françeskanë. Ai zgjodhi gegnishten për shkrimet e veta. I njohur për poezitë e një humori të rrallë, është i pari që bëri art idiomim.

Gjergj Fishta - autori më i njohur françeskan. Ai shkroi lirikat e himinit, të dëshpërimit nacional e të përvujtnisë (*Mrizi i Zanavet, Vallja e Parrizit*), epin *Labuta e Malcís*, satirat (*Anzat e Parnasit* etj.), veprat dramaturgjike klasike (si *Juda Makabë*) dhe drejtoi jetën kulturore e letrare të Shkodrës, të qendrës së madhe kulturore shqiptare të gjysmës së parë të shekullit XX. Ishte kreu i liceut "Ilyricum" dhe i revistës-kult *Hylli i Dritës*.

Në traditën e etërve të mëdhenj

shqiptarë, Shtjefën Gjeçovi mblodhi kodin tradicional të Veriut, *Kanunin e Lekë Dukagjinit*, që në trajtë libri u botua pas vdekjes së tij, më 1933. *Kanuni...* është vepër e Gjeçovit; shfaq shenjat e dorës së tij në zgjedhjen e lëndës dhe në strukturimin e saj. Gjeçovi më fort duket te kreu i parë, *Kisha*. Autori sillet me Kishën si me një nyjë të traditës shqipe, si me një autoritet tradicional, të lidhur e të rritur me jetën e shqiptarëve.

Puna e Gjeçovit, gjurmimi i traditës shpirtërore e materiale të vendit, është tipike për françeskanët.

Në planin e gjuhës, gegnishtja e rrallë e Gjeçovit hapet më së thelli tek *Agimi i Gjytetnís*.

Vinçenc Prennushi shkroi vjershat e ëmbla, të ndjeshme, në shkoderanishte (*Gjeth e Lule*). Ai ishte përkthyes "i hollë e elegant" (Eqrem Çabej).

Bernardin Palaj e Donat Kurti mblodhën e botuan me durim e dashuri të rrallë visaret e kombit, përralla e legjenda. Në qarkun e botimeve të tyre, më të njohurat janë Kângët kreshnike.

Të mos lëmë pa përmendur këtu Marin Sirdanin, françeskanin historian, i cili rrëfeu me ngë në gjuhën e maleve.

Anton Harapi ishte pedagog, moralist e shkrimtar. Autor që gjurmoi përherë fuqinë e logjikës e të retorikës, pra të argumentit verbal. Njeri që shkriu veten, duke ecur pas një ideje: kërkimi i lirisë nëpërmjet dritës së kulturës e të edukimit të shqiptarëve.

Justin Rrota - gramatolog e shkrimtar, një stilist i rrallë i shqipes.

Zef Pllumi, françeskani i fundit i

këtij qarku kohor. Vepra themelore e tij është jeta, qëndresa, humaniteti i ruajtur thellë, kur njeriu vështirë mund të mbetet njeri: nën diktaturën e zezë.

Vepra që la Pllumi para se të shkonte, *Rrno vetëm për me tregue*, është kujtim dhe dëshmi personale e sociale. Një *pasqyrë* në të cilën duhet të shikohemi thellë, për të mësuar e për të mos harruar.

Me Fishtën e Pllumin do të shoqërohemi veçan në vijim, për t'i kapur cepet e shekullit të françeskanëve shqiptarë.

III. ATË GJERGJ FISHTA

Vepra letrare e Gjergj Fishtës është më e gjera e shkollës letrare të françeskanëve. Vepra që mban e reflekton shenjat themelore të kësaj shkolle.

Kjo vepër, pavarësisht zhanreve, në esencë mbetet poezi.

Fishta botoi librat e njohur lirikë *Mrizi i Zanavet* dhe *Vallja e Parrizit*, në të cilët kryqëzohen temat atdhetare e të besës. Vargu i Fishtës është klasik. Diskursi - herë himnizues, përkushtues e herë kritik, gjithherë substancial, meqë merr e jep të gjallë jetën shqiptare. Fishta thuri poezinë e lavdit e të adhurimit në modelin biblik e oral, mallkoi si malësor, vuajti, u rebelua, u rrembye e u trenua si shqiptar.

Lahuta e Malcís është epi nacional i shqiptarëve; vepër që kurorëzoi përpjekjet e autorëve tanë për të shkruar epin. Ajo ka model themelor kulturën orale shqipe, epikën shqipe, Kángët kreshnike. Ep që s'hyn në poetikën klasike të zhanrit. Fishta strukturoi tekstin e tij duke kënduar një temë në disa variante, për të fituar mozaikun e shfaqjeve të jetës shqiptare në luftën kundër sllavëve, në luftën për liri.

Lahutën e Malcís e karakterizojnë



Karl Prennushi, Fishta, Justin Rrota e Shtjefën Gjeçovi

veprimet e larta, madhështore, shpesh legjendare. Diskursi është kryesisht heroik, ndërsa situatat - dramatike. Gjithë kjo prodhon një tekst dinamik, përkundër gjerësisë epike.

Fishta jeton brenda tekstit si strukturues, zbulues/krijues e komentues. Strukturuesi lidh fjetet e rrjetit të gjerë intertekstual që jeton brenda *Lahutës së Malcís*; krijuesi zgjedh diskursin, figurën, artikulon emocionin, vë diskursin nën shenjën e subjektivitetit, thur tekstin e hipertekstin, ligjëron në këngë autoriale (si *Lugati*); komentuesi del në rrjetin e ideve dhe të deklarimeve të hapura përballë situatave.

Lahuta e Malcís është monument letrar, por edhe vepër e identitetit shqiptar.

Satirat e Fishtës tematikisht, në radhë të parë, janë politike e sociale. Vepra më e njohur satirike e tij është *Anzat e Parmasit*, e cila satirizon politikën e sociumin shqiptar të kohës, duke kaluar paprerë nga persona të caktuar te dukuritë. Këtu figura letrare reduktohet e shpesh tretet dhe Fishta flet pa u mbuluar, ligjëron në qarkun e diskurseve mimetike.

Vepra dramaturgjike e Fishtës, siç tregojnë metatekstet (*kangë melodramatike, poem melodramatik, melodram barituer, melodram*) dhe siç del nga analiza e tekstit, janë këngë, poezi. Fishta ligjëron me figurat e formulat e tij tipike të lavdit e të mallkimit. Situata dramatike ka pak, me përjashtim të tragjedisë *Juda Makabé*; veprat e tilla të Fishtës janë poezi me strukturë formale dramaturgjike.

Vepra më e njohur dramaturgjike e Gjergj Fishtës është *Juda Makabé*, një tragjedi e trajtave klasike, me temë biblike. Prijësi i zgjedhur, Juda Makabé, tradhohet, atdheu humbet lirinë. Teksti mbyllet duke vajtuar humbjen e lirisë dhe duke mallkuar tradhtarët.

Juda Makabé shenjon secilën kohë e secilin vend, në situatën e rëndë, të zezë, kur njerëzit tradhetojnë/flijojnë prijësin që kanë zgjedhur vetë.

Tematikisht e ndryshme, melodrama *Sh'Françesku i Asizit*, u botua brenda *Valles së Parrizit*, më 1925. Siç nënvizon Fishta në paratekst, u shkrua "mas ravës së melodramit në prozë t'A. Ugheti-t" dhe u shfaq për të shënuar 700-vjetorin e themelimit të Urdhrit

françeskan, më 1909, në Shkollën Fretnore të Shkodrës.

Sh'Françesku i Asizit është vepër e idesë, këndim i idesë; veprimi është reduktuar maksimalisht, thuajse mungon. Teksti thuret në përballjen elementare ndërmjet njeriut që identifikon lumturinë me pasurinë dhe atij që gjen lumturinë kur ndihmon tjetrin, kur të gjithë i quan dhe i ka vëllezër. Kjo e dyta është ideja e përvujtinisë, heqja dorë nga çdo e mirë për vete, vënia në shërbim të tjetrit. Kështu mendojnë e sillen françeskanët kudo e kurdo.

Kjo melodramë poetizon historinë e Shën Françeskut. Ai është i pari i djalërisë, njeriu që jeton kënaqësitë e jetës, poeti. Pastaj lë të gjitha; ruan poezinë dhe zgjedh rrugën e përvujtinisë, për t'u shërbyer njerëzve.

Situata themelore është e *Sh'Françesku i Asizit* ajo e përballjes së tregtarit (babai i Françeskut) me poetin (Fr Françesku). I pari koprac, i mbytur në frikën e jetës materiale, i dyti ndjek shpirtin e vet, përkushtimin për të lënë çdo kënaqësi dhe për të fituar, nëpërmjet shërbimit, lumturinë e përjetjeme.

Në thelb kjo situatë rishfaqet te tregimi i njohur i Ernest Koliqit *Tregtar flamujsh*. Vërtet, te Koliqi, tema e tillë fiton rreth të ri zgjerimi, bëhet temë e idealit dhe e idealitetit të artistit, përballë njeriut që ndjek vetëm përfitimin personal, egon e vet.

IV. ATË ZEF PLLUMI

Atë Zef Pllumi, që shkoi para një viti, ishte françeskani i madh i fundit i Rrethit të françeskanëve (Eqrem Çabej) të Shkodrës, i shkollës e frymës së Fishtës. Ai treti jetën e vet, për të mbetur Njeri, dhe shkoi pasi la dëshminë për veten e për shqiptarët. *Rrno vetëm për me tregue* është rrëfim e dëshmi personale, që, rrathë-rrathë, zgjerohet në dëshmi për françeskanët, Kishën

Katolike Shqiptare e shoqërinë shqiptare në tërësi nën diktaturën e egër.

Pllumi rrëfen në gjuhën e françeskanëve, në idiomën e dashur, me figurat ambientale. Gjithë kjo forcohet kur ngjarjet e rrëfyera ndodhin në ambientin e këtij idiomi, në Shkodër, në Veri.

Dëshmia e Atë Zef Pllumit, e përshkuar me përvujtininë e françeskanit, ndërtohet mbi kujtesën e rëndë të tij. Duke nisur si letërsi personale, zgjerimi i dëshmisë, e bën atë dëshmi për Kishën katolike e shqiptarët, të prerë me rrëfime për persona e ngjarje që bëjnë nyjat e kohës. Përvujtnia tipike e françeskanit e mban disi prapa shenjën personale dhe frati i madh, ai që vuajti sa askush, vuan për të tjerët dhe harron veten. Vuan sa s'ka, por jeton *vetëm për me tregue*, ky është një mision.

Kujtimi e dëshmia lidhen e zgjidhen paprerë në rrëfimin e Pllumit. Kujtimi është esenca që prodhon dëshminë. Por, jo rrallë, rrëfimi del kujtim i pastër, sidomos kur autori rrëfen jetën e vet. Sa herë fiton kujtimi, *Rrno vetëm për me tregue* shtyhet në qarkun e zhanreve të shkrimit personal; kur forcohet e mbretëron dëshmia, takohet sociografia.

Në rrëfimin e Pllumit hyjnë persona të njohur, njerëz të besës e të dijës, të pushtetit e të vuajtjes, si dhe të tillë që nga pushtetarë u bënë pre e po atij pushteti.

Rrëfimi, dëshmia e Atë Zef Pllumit është përshpirtje e thellë për njerëzit që tretën jetën nën diktaturën e egër; dëshmi, rrjet i të vërtetave për këtë diktaturë; një vepër që nis katarzën shqiptare, duke u përballur me dhembjen, me të vërtetën e zezë.

Rrno vetëm për me tregue është dëshmi e misionit të përmbushur të Atë Zef Pllumit. Një mision që vëllain e vogël të Shën Françeskut e bën françeskan të madh, njeri të epokës. Po pra, përvujtnia është

madhështore.

Në planin letrar, *Rrno vetëm për me tregue* dëshmon edhe një herë se shkollat letrare shtrihen përtej një vendi e kohe, si për ta tretur shenjën kronologjike/historike dhe për ta forcuar atë tipologjike.

V. FRANÇESKANËT SOT

Në veprën e rrallë të françeskanëve shqiptarë jetojnë besa e burrnia, etika e psika etnike, gazi e idhsia, një kozmos kulturor e social autentik. Me këtë ideologji vjen vepra e tyre *sot*, për të provuar konstantat e përthyerjet e jetës shqiptare. Një rrugë për ta zbuluar e matur veten. Le të rikujtojmë Kângët kreshnike, *Kanunin e Lekë Dukagjinit e Labutën e Malcís*, veprat e gjalla të identitetit shqiptar. Janë të tilla, sepse mbajnë brenda jetën, gjuhën e frymën shqiptare.

Fr Françeskanët *sot* sjellin të *djeshmen*, nyjat e kalesës shqiptare, dhe shenjojnë rrugën e *së nesërme*.

Vepra e françeskanëve është trashëgimi letrar, kulturore e nacionale. Me françeskanët "shqiptari zbulon vetveten" (Ernest Koliqi). Te françeskanët vijomë të zbulojmë shqiptarin e përjetshëm, me të gjitha shenjat dhe esencat.

LITERATURA

Dr. Eqrem Çabej: *Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe*, Tiranë, 1936

Shkrimtarët shqiptarë II, Tiranë, 1941

Ernest Koliqi: *Shënim në Pasqyrat e Narçizit*, Romë, 1963; *Dy shkollat letrare shkodrane*, Romë, 1954-1961 (në *L'Albanie Libre*)

At Zef Pllumi: *Rrno vetëm për me tregue*, Tiranë, 2006; *Histori kurrë e shkrueme*, Tiranë, 2006

Kujtim M. Shala: *Shekulli i letërsisë shqipe*, Prishtinë, 2006

SI U SHKATËRRUAN LIBRAT?!

/vijon nga numri i kaluar/

ISAAC D'ISRAELI

Veprat e Antikës shpeshherë janë shkatërruar nga nxitja e murgjive. Nganjëherë duket se ata edhe i kanë gjymtuar ato, pra pasazhet të cilat nuk kanë ardhur deri te ne, të cilët në mënyrë evidente dikur kishin ekzistuar; dhe rastësisht ndajshkrimet dhe falsifikimet përbënin një shkatërrim të një forme tjetër, pra shtesat në origjinale. Ata qëndronin të palodhshëm në fshirjen e veprave më të mira të autorëve më eminentë grekë dhe latinë, me qëllim që t'i transkriptojnë jetët e të shenjtëve të tyre me velon e harresës. Njëri nga librat e Livit është në Vatikan, por shumë i shfyturuar nga ana e ndonjë prifti fanatik, i cili duket se ka shkruar mbi të lutje nga meshari ose psalme. Por, libra të tjerë të tillë janë gjetur edhe kohëve të fundit në të njëjtin vend. I inflamuar me zellin e verbër kundër gjithçka-je që është pagane, Papa Gregori VII kishte dhënë urdhër që biblioteka e Platin Apollos, thesar ky i letërsisë, i formuar me trashëgimi të tërë të perandorëve, t'i dorëzohej flakës. Ai e kishte dhënë këtë urdhër mbi nocionin e kufizimit të kujdesit të klerikëve vetëm në skriptat e shenjta! Nga kjo kohë mësimi i vjetër, i cili nuk ishte sanksionuar nga ana e autoritetit të kishës, ishte ndarë prerazi në *profane* - si i kundërt me atë *sakrale*. Ky papë thuhet se ka djegur edhe veprat e Varros, romakut të ditur, me qëllim që Shën Augustini të shmangej nga akuza për plagjiaturë, duke i qenë pra shumë borxhli Varros për shumëçka të thënë në veprën e tij *Qyteti i Zotit*. Jezuitët, ndërkaq, të dërguar nga Perandori Ferdinand për ta përzënë

luterianizmin nga Bohemia, e kishin kthyer këtë mbretëri të lulëzuar në shkretëtirë, nga e cila kurrë nuk e ka marrë më veten. Duke konsideruar se servilizmi ndaj tiranit nuk është diçka afatgjatë, ata kanë ndërmarrë një shkatërrim të hatashëm të letërsisë nacionale: çdo libër të cilën ata e kanë dënuar, ajo është shkatërruar, bile edhe ato të Antikës; kronikat e ndryshme të kombit të tyre janë ndaluar të lexohen dhe njëkohësisht shkrimtarët janë ndaluar që të hartojnë diçka që ka për temë letërsinë bohemiane. Gjuha amtare është përjashtuar dhe lënë vetëm si një shenjë e errësirës vulgare dhe se vizitat nëpër shtëpitë e tyre ishin bërë vetëm sa për t'i inspektuar librat dhe bibliotekat e bohemianëve. Me librat dhe gjuhën e tyre të humbur, ata kishin humbur edhe karakteristikat e tyre nacionale si dhe pavarësinë e tyre njëkohësisht.

Shkatërrimi i bibliotekave gjatë regjimit të Henrit VII, pra gjatë shpërbërjes së manastireve, është përmendur nga Xhon Bali. Ata që kanë blerë tempujt fetarë i kanë marrë bibliotekat si pre, me të cilat kanë fshirë mbolet e tyre ose i kanë shitur librat si letër tepricë apo edhe i kanë dërguar si ngarkesa anijesh për te libraldhësit e huaj.

Kurse frika e shkatërrimit të librit ka ndikuar që shumë njerëz të fshehin dorëshkrimet nën dhé dhe në mure të vjetra. Në kohën e reformacionit, pra të fushatës ndaj librave apo dorëshkrimeve të iluminuara, ishte përdorur germa e kuqe në faqen titullare: çdo libër që ishte dekoruar me një germë të tillë të kuqe ishte hedhur në flakë i cilësuar si paragjykses. Germat e kuqe dhe figurat e ilustruara ishin cilësuar si shenja të qarta të

qenësisë së tyre papistike dhe diabolike. Ne ende gjejmë volume të tilla të gjymtuara me germa të tilla të kuqe, por numri më i madh i tyre tashmë është zhdukur. Shumë nga to janë gjetur nën dhé, të harruara; disa që i kanë shpëtuar flakës janë shuar nga lagështia: ky ishte fati i keq i librave gjatë persekutimit.

Puritanët, nga ana tjetër, kishin djegur gjithçka që kishin hetuar se mohon origjinën papnore. Ne dimë për shumë ngjarje kurioze të grabitjeve fanatike, për gjymtimin e imazheve dhe për fshirjen e pikturave. Ekspeditat heroike të Dousingut janë zhurnalizuar nga vetë ai: një Kishot fanatik, trimëria e të cilit është skulpturuar nëpër katedralet tona ku theksohen edhe hallet në të cilat kishte rënë. Në vijim po japim edhe disa detaje nga ditari i këtij Gothi të tmerrshëm, gjatë fushatës së tij për reformim. Hyrjet janë shprehur me koncizitetin lakonik dhe si të tilla marrin një humor të thatë. "Në Sunbury ne kemi rrënuar dhjetë engjëj në xham. Në Barham dymbëdhjetë apostuj në altar dhe gjashtë piktura të dyshimta; gjithashtu edhe tetë në kishë, një llambë me kryq mbrapa, si dhe kemi rrënuar shkallët dhe kemi marrë katër mbishkrime". "Shtëpia e Zonjës Brus, kapela, piktura e Zotit Baba, e Trinitetit, Krishtit e Mysafirit të Shenjtë, si dhe gjuhët e çarja janë shënuar të rrënohen dhe zonja ka premtuar ta bëjë një gjë të tillë". Në një vend tjetër "ata kanë prishur e thyer gjashtëqind piktura të dyshimta, tetë Mysafirë të Shenjtë dhe tri piktura të Birit". Dhe në këtë mënyrë ai dhe pasuesit e tij kanë pastruar njëqind e pesëdhjetë famulli. Nga këto veprime, pra nga këto shkatërrime të tmerrshme edhe ka dalë fraza Dousing. Peshkopi

Hall kishte ruajtur dritaret e kapelës së tij në Noruiç nga shkatërrimi i tillë, duke i nxjerrë jashtë kokat e figurave, prandaj edhe sot shihet se shumica e figurave janë mbuluar me qelq të bardhë.

Gjatë luftërave të ndryshme civile shumë biblioteka kanë pësuar si në dorëshkrime, ashtu edhe në libra të shtypura. “Më mbushet mendja të them”, thotë Fulleri, “se luftërat ndërmjet Jorkut dhe Lankasterit, të cilat kanë zgjatur gjashtëdhjetë vjet, nuk ishin aq shkatërruese sa luftërat tona moderne që kanë ndodhur vetëm për gjashtë vjet.” Ai këtu aludonte në grindjet parlamentare në kohën e regjimit të Karlit I. “Përderisa të parët që i përmenda dallimet e tyre i pajtonin me *religionin e njëjtë*, prekja e tyre në ndërrimin e gjithçka-je lejonte dëshmi, ndërsa *luftërat tona civile*, me bazë në *fraksionet* dhe *variantet* e religjioneve i kanë ekspozuar të gjitha regjistrat e kishave si pré të dhunës së armatosur, duke krijuar kështu një vakum të lig, i cili do të jetë i hetueshëm në *historinë angleze*”.

Pra, mungesa e librave që kanë të bëjnë me katolikët në këtë vend ndërlihet me dy rrethana; shkatërrimin e librave dhe dokumenteve katolike nga ana e pasuesve të regjimit të Karlit I, dhe nga shkatërrimi i tyre nga vetë katolikët, nga frika e tmerri i dënimeve të rënda që përjetonin pronarët e tyre.

Kur të madhërisht Gustavit të Suedisë i ishte propozuar që ta shkatërrojë pallatin e Dukës së Bavarisë, ky hero kishte refuzuar me dashamirësi, duke vënë re: “Mos të kopjojmë shembujt e paraardhësve tanë analfabetë, të cilët, duke zhvilluar luftë kundër çdo krijimi gjenial, e kanë kthyer emrin e GOTH-it në një proverb universal të shtetit më të zi sa i përket barbarisë”.

Edhe civilizimi i shekullit të tetëmbëdhjetë nuk mund të përjashtohet

nga damka e furisë shkatërrimtare të turmave pa tru, ku në qytetin më të pastër të Evropës, dorëshkrimet shumë të vlershme të të madhit Erl Mensfeld, ishin përfshirë në flakë gjatë përlëshjeve dhe trazirave të vitit 1780.

Ndërsa në vitin 1599, godina e shkrimeve kishte përjetuar çmendinë e ngjashme me atë të bibliotekës së Don Kishotit. Uatoni jep listën e shkrimtarëve më të mirë, librat e të cilëve ishte urdhëruar që të digjeshin nga prelatët Uitgift dhe Bankroft, të udhëhequr nga

përçarjet puritanike dhe kalvinistike. Sikur hajdutët dhe të paligjshmit, ishte urdhëruar që *të merret gjithçka që mund të gjendet*. - “Gjithashtu ishte dhënë dekret që në të ardhmen mos të shtypen satira dhe epigrame. Nuk duhet të shtypeshin as shfaqjet për pa u kontrolluar dhe lejuar nga kryepeshkopi i Santerburit dhe nga peshkopi i Londrës; madje as *historitë angleze*, supozoj këtu që as romanet e romancat, pa sanksionet e këshillit të fshehtë. Çdo pjesë e kësaj natyre, e palicencuar, që mund të shpëtojë e të dalë jashtë, do të kërkohet me ashpërsi, do të tërhiqet dhe do të dërgohet te dega ekleziaste në shtëpinë në Londër.” Në një periudhë më të vonshme, dhe nga një parti opozitare, në mesin e shumë mocioneve ekstravagante të bëra në parlament, njëri prej tyre ishte që të shkatërroheshin të gjitha regjistrimet në Kullë, ku më pastaj kombi do të ndërtohej në themele të reja. Një hap i tillë ishte iniciuar të ndërmerrej edhe gjatë revolucionit



francez nga të ashtuquajturit “true sans-culottes”. Të ne Sër Metju Hal e kishte hetuar dobësinë e këtij propozimi “dhe kishte tërhequr pas vetes të pabindurit dhe ua kishte mbyllur gojën fanatikëve”.

Humbje të mëdha u kanë ndodhur edhe individëve në zë, emrat e të cilëve kanë shërbyer për t’i larguar demonët e shkatërrimit të letërsisë. Njëra nga këto ndodhi, shumë interesante, është edhe fati i bibliotekës së Aristotelit; i cili, sipas të dhënave greke, njihej si mbledhësi i parë i librave. Mirëpo, veprat e tij kanë ardhur te ne thuhet krejtësisht aksidentalisht. Por, nuk mund të themi se kanë shpëtuar nga humbjet e pariparueshme të tyre dhe pa një dyshim të lehtë sa i përket autenticitetit të tyre. Rrëfimi të cilit i referohemi është theksuar nga Staboni, në librin e tij të trembëdhjetë. Aty thuhet se librat e Aristotelit kanë ardhur nëpërmjet nxënësit të tij Teofrastit, por më vonë një grup analfabet i kishte mbajtur ato në dry pa i përdorur kurrë, por të varrosura në

dhe! Apellioni, një mbledhës kurioz, i kishte blerë pastaj ato, por i kishte marrë dorëshkrimet e dëmtuara nga koha dhe lagështia, duke i mbushur pastaj mungesat. Tashmë është shumë e pamundur të dimë se deri në çfarë shkalle Apellioni e ka prishur dhe terratur tekstin. Por, keqpërdorimi nuk ka përfunduar me kaq. Kur Sylla me marrjen e Athinës i kishte sjellë ato në Romë, i kishte dërguar për përkujdesje të Tiranio, gramaticien, i cili i kishte punësuar skriptorët që t'i kopjojnë ato. Veprat kishin kaluar nëpër duart e tij pa korrektime ku edhe ishte përdorur një liri e madhe. Kështu që edhe fjalët e Stabonit kanë dalë shumë të forta: "Ibique Tyrannionem grammaticum iis vsum atque (ut fama est) *intercidisse*, aut *invertisse*." Ai në fakt këtë e jepte si raport, por kjo është konfirmuar edhe nga gjendja në të cilën janë gjetur më vonë këto vepra: Averrosi deklaronte se e kishte lexuar Aristotelin katërdhjetë here, duke arritur që ta mësojë atë perfektë dhe për ta dëshmuar këtë kishte botuar pesë faqe (të librit të madh) dorëshkrim si koment.

Ne gjithashtu kemi humbur shumë literaturë nga ana e paraardhësve tanë analfabetë dhe maliciozë, pra i kemi humbur veprat e atyre që nuk kanë qenë si ata, por kanë qenë autorë të ditur dhe gjenialë. Shumica e letrave të Lejdi Meri Uoterli Mantenjtit janë shkatërruar dhe për këtë jam informuar nga nëna e saj. Bile edhe ato pak letra që së fundi kanë pasur fatin të botohen janë gjetur të varrosura në një arkë familjare.

Pas vdekjes së dijetarit Peiresk, oda në shtëpinë e tij qëndronte e mbushur përplot me letra të dërguara nga dijetarët më eminentë të kohës. Dijetarët e tjerë në Evropë i drejtoheshin Peireskut gjatë vështirësive të tyre diturore, sepse ai në një kohë cilësohej si "avokati i përgjithshëm" i

republikës së letrave. Kjo pasuri letrash kishte mbetur pronë e mbesës së tij, por ajo kishte preferuar që t'i digjte gradualisht këto epistula me qëllim që të mos shpenzonte dru për ngrohje.

Dorëshkrimet e Leonardo da Vinçit kanë vuajtur ngjashëm nga të afërmit e tij. Kur një mbledhës kurioz i kishte zbuluar disa prej tyre, me gjenezitet i kishte dërguar te një pasardhës i piktorit të madh, i cili me këtë rast shumë ftohtë kishte thënë "se një (vepër) e tillë ka pas qëndruar në çardak për shumë vjet, nëse nuk e kanë shkatërruar ende minjtë!".

Menagu, ndërkaq, vëren se si një mik i tij kishte pasur një bibliotekë të gjerë, e cila i ishte djegur nga flakët, ku kishin humbur një numër i madh i dorëshkrimeve të vlefshme, duke përshkruar kështu fatkeqësinë më të madhe që mund t'i ndodhë njeriut të letrave. Pastaj, njerëzit e tij ishin munduar që ta pajtojnë atë me kompozimin e një traktati të vogël të titulluar *De Bibliothecâ incendio*. Kjo është shumë kurioze, sepse edhe në ditët e sotme njerëzit e letrave shndërrohen në subjekte të fatkeqësive të ngjashme, prandaj do të ishte mirë që ata që i sigurojnë librat të mos i *lejojnë autorët e tyre që t'i ruajnë vetë ato*.

Zjarri në bibliotekën e Kotonit ka rrëgjuar dhe shkatërruar shumë dorëshkrime anglo-saksone, humbje kjo që tashmë është e pariparueshme. Gjithashtu në tjetrën anë fjalori i famshëm persian i Meninskit është përballur me një fat të lig. Rariteti i tij ndërlihet me rastin e rrethimit të Vjenës nga turqit: një bombë kishte rënë në shtëpinë e këtij autori ku kishte prishur një numër të madh të trashëgimisë së tij. Ekzistojnë disa pjesë të kësaj vepre shumë të çmueshme që nuk shfaqin evidencat e bombës; por edhe shumë pjesë të saj janë njollosur nga uji dhe si të tilla janë djegur. Vuajtja

e autorit pas humbjes së dorëshkrimeve të tij askund nuk është përshkruar më fuqishëm sesa me rastin e Antoni Urkeusit, i cili mund të cilësohet si njëri nga dijetarët më fatkeq të shekullit të pesëmbëdhjetë. Humbja e dorëshkrimeve të tij duket se menjëherë ka pasur me çmendinë e tij. Ai, në Forli, ka pasur një shtëpi banimi ku përgatiste për botim një libër të rëndësishëm. Dhoma e tij ishte e errët dhe ai në përgjithësi shkruante me ndihmën e dritës së llambës. Pasi kishte dalë jashtë, ai kishte lënë llambën e ndezur; fletët e afërta shumë shpejt kishin marrë zjarr dhe për një kohë të shkurtër biblioteka e tij ishte kthyer në hí. Pasi ishte njoftuar, ai menjëherë kishte vrapuar për në atë vend dhe duke i rënë murit mbi derë me kokë kishte bërë titur me një gjuhë të ashpër blasfemuese: "Jezu Krisht, çfarë krimi të madh paskam bërë unë! Cilët nga ata që kanë besuar në ju i kam trajtuar në këtë mënyrë të egër? Më dëgjo se çka jam duke thënë, sepse kam besë dhe jam shumë i vendosur. Nëse do të ligështohesh aq shumë sa që do të më nevojitet që t'ju thërras juve në momentin e vdekjes, mos më dëgjo, sepse nuk do të jem me ju. Do të preferoj ferrin dhe eternitetin e vuajtjes". Ata që dëgjuan për fatkeqësinë e tij u përpoqën ta ngushëllojnë dhe ta pajtojnë, por nuk ia arritën. Ai e la vendbanimin e tij, jetoi pastaj i tërbuar dhe mori malin ku sillej i çmendur e pa pushim.

Ngjashëm, Kastelvetroja, komentatori italian i Aristotelit, pasi që kishte dëgjuar se shtëpisë së tij i ishte dhënë flaka, kishte vrapuar i limeritur nëpër rrugët e qytetit duke u bërë titur kalimtarëve, *alla Poetica! alla Poetica! te Poetika! te Poetika!* Në atë kohë ai ishte duke bërë komentin e tij për *Poetikën* e Aristotelit.

*Përgatiti nga anglishtja:
Nysret Krasniqi*

LIBRI MIKROMODEL KOMUNIKUES

DR. IBRAHIM BERISHA

/vijon nga numri i kaluar/

Vija ndarëse mes librit dhe lexuesit në njërën anë dhe medias dhe auditorit, në anën tjetër, është e ndryshme dhe pak e krahasueshme, varësisht nga gasjet. Studimet e fundme të komunikologëve për zotërimin e storieve dhe programeve të amatorëve në media, që u bënë publike nga komunikologu gjerman Tomas Shnedler, orientojnë ende më shumë gjykimin për ndryshimin e madh që ekziston ndërmjet librit dhe televizionit, po njëkohësisht edhe ndryshimet ende më të mëdha që do të ndodhin në të ardhmen antropologjike kulturore dhe informuese të njeriut.

Kur themi kulturë, më këtë nocion kuptojmë edhe aftësitë krijuese të njerëzve, të cilët nuk janë të profesionalizuar, ata të bëjnë apo të bëhen pjesë, duke pasur një standard të arsimuar medial. Hyrja në tregun medial, do të thellojë ende më shumë këtë dimension dallues të librit me televizionin. Nuk mund të shmanget fakti se libri nuk do të humbë asnjëherë krejtësisht elementin që nis të konstituohet në Antikë dhe mbërrin të riformulohet në Mesjetë, se ai është një kult dhe jo një instrument për të komunikuar njerëzit e zakonshëm. Libri i kësaj kohe u dedikohet lexuesve të veçantë, prandaj ai konsiderohet thesar i jashtëzakonshëm privilegjues. Nga pozita e sotme është vështirë të përcaktohet si do ta vlerësonte

filozofia biblike, cila do të ishte pozita e medias, kur dihet pozita e shkrimit dhe librit. Historianët e librit, ndër të cilët edhe sociologu i librit Stipçeviq, kanë theksuar oreolin e librave të shenjtë, në të cilët gjenden investimet e shumta, përmes prarimit edhe citateve tilla që përcjellin mesazhin e përhershëm, se ato u shkruan apo ishin dhunti e *Zotit*. Sot vërejmë, asgjë nuk është dhënë në një formë të tillë kaq complete dhe të përbotshme sa librat e shenjtë, përshkrimi i mesazheve të shenjta, me forcë të tejbotsme. Antropologët e librit këtu vlerësojnë edhe karakterin ideal që i është dhënë librit, ndërkohë këtë karakter, në anën tjetër, pyetje është nëse mund ta ketë media? Në vend të idealitetit, atij më tepër i përshkruhet misterioziteti. Edhe komunikologët japin përgjigjen e tyre, që mund të arsyetohet, duke transferuar një pjesë të këtij ideali apo shenjtërie te mediat. Nëse më herët për të dëshmuar pafajësinë, një njeri ka bërë be duke mbajtur dorën mbi Bibël apo Kuran, në ditët e sotme kjo nuk bëhet më në kënde të ngushta të objekteve të kultit. Një personalitet i njohur, një senator apo qeveritar, këtë betim krahas përpara kopertinave të dizajnuara prore bukur të librave të shenjtë, do ta bëjë edhe përpara mediave. Forca kulte e librit kështu bart një shkëndijë edhe në forcën jokulte të medias, në televizion, fjala vjen, apo para aparateve fotografike.

Libri është pamje e një gjendjeje të qetë kulturore, media është shumë rrallë pamje e kësaj qetësie.


Vërteton vlime të dramave dhe të konflikteve. Libri nuk atakon askënd, është vlerë në një hapësirë të veten gjithmonë, atje ku nuk mbërrin askush nga lloji tjetër ta shqetësojë, ndërsa ta zëmë, edhe përmbajtja më e thjeshtë komerciale, një marketing i pijeve jofreskuese në televizion apo internet, del pasqyrë e konfliktit për treg që e reflekton vetë media. Lufta për një blerës më shumë, duke ia marrë nga dora prodhuesit tjetër, shpreh konfliktin e përhershëm që përcjell edhe një përmbajtje specifike mediale, siç mund të jetë stوريا plastike për një prodhim krejt të zakonshëm. Media në thelb, është pjesë e konfliktit, e luftës për më shumë pasuri dhe për më pak arsye në zgjedhjen e mjeteve që do të përdoren për të realizuar qëllimin. Media ngrihet mbi parimin se mjeti arsyeton qëllimin, ndërsa libri provon të mbahet në linjën filozofike se qëllimi arsyeton mjetin.

Prodhuesit e librit nuk jetojnë nga privilegjet, janë vuajtës që njihen, që nga krijimi i shtypshkronjave të para, dhe aq më shumë, para zbulimit të tyre, duhej të ndiqnin një proces të tmerrshëm teknologjik të prodhimit të shkrimit të shtypur. Mediat u krijuan mbi theksimin e privilegjeve, duke qenë që nga fillimi pjesë e grupeve të interesit, për të mbërritur privilegje apo për të mbështetur mbajtjen e tyre. Parimi mbi pavarësinë e medias është mbulesa më pllakative për pamundësinë tyre të jenë të pavarura. Nëse nisemi nga parimi themelor se liria dhe e drejta buron nga liria dhe e drejta e individit, kjo

është pak e besueshme se mund të realizohet në një konglomerat, apo korporatë, pjesë të cilave janë praktikisht mediat e sotshme.

Të mendojë njeriu se sa vështirë është të ndërtohet, të pajisesh dhe të mbash një bibliotekë në një lagje apo në një shkollë? Vetë përmendja e idesë për të ndërtoar një qendër bibliotekare, nuk sjell shumë reagime pozitive. Sa lehtë ngrihet një qendër interneti, duke mos pasur asnjë lloj reagimi negativ. Do kujtuar se bibliotekat nacionale u ngritën bashkë me krijimin e kombit, me industrializimin, ndërsa televizioni në postindustrializim njohu zhvillimin eksploziv. Nevoja për lexim në këtë proces u transferua në nevojë për komunikim, madje edhe duke përdorur prore e me shumë shkrimin. Duke zëvendësuar shkrimin e letrave të kujdeshme dikur, me një stil fin, me fakte dhe me bindjen se ato letra do të ruhen dhe do të jenë pjesë e fondit të kujtimeve nga ai që i merr, sot letrat e dërguara përmes mesinxherit dhe *e-mail adresave*, nuk pretendojnë një stil të kujdeshëm, fakte dhe kuptime të qarta mbresëlënëse. Letra e dikurshme postare kishte qëllimin e bartjes së ideve, emocioneve dhe seriozitetit, letra e sotme mediale ka qëllim komunikimin dhe argëtimin, të shumtën, joseriozitetin, në thelb të vet.

Fondi i librit ka shërbyer si një mjet i fuqishëm për të ndërtoar kulturën nacionale, për të zhvilluar standardet dhe vlerat e besimit dhe të përkushtimit, ndërsa media shërben për të transformuar kulturën nacionale, për të mos respektuar standardet dhe vlerat e besimit dhe të përkushtimit, dhe kjo e tëra do të ngrejë dilemën e ringritjes së stereotipeve dhe



paragjykimeve. Bota e sotme është e dominuar nga stereotipet dhe paragjykimet e krijuara nga ndikimi i konsumit të madh të përmbajtjeve mediale. Me librin ishte shumë e lehtë të qërohen hesapet, duke e mbytur ende pa u krijuar apo duke e mbyllur hapësirën e tij të qarkullimit në një rreth fare të ngushtë. Libri është shkatërruar lehtë. Përkundër tij, televizioni, media, është vetë djalli i nxjerr nga shishja. Nuk është e mundur në këtë kohë të digjitalizimit mbrojtja nga valët që sjellin program nga një kënd i botës në një kënd tjetër. Qindra satelitë hapësinorë shërbejnë për të shpërndarë përmbajtje mediale gjithkrah në rruzull me çmime përditë më të ulëta. Kjo rrit sigurinë profesionale të medias. Shkatërrimi i Bibliotekës së

Aleksandrisë në Egjipt (shek. III) nga të krishterë fanatikë, nuk krijon frikë serioze analogjie, se një gjë e tillë mund të ndodhë tashti me mediat. Policentrizmi medial ka siguruar në shumë qendra kulture, librat e skriptuara, apo edhe librat e të gjitha llojeve.

Një tjetër çështje, në kontekstin e raportit libri-media, duket edhe përmasa e identifikimit të tyre me vlerat njerëzore. Çfarë qëndrime ndërton publiku duke lexuar një libër dhe çfarë duke shikuar një përmbajtje mediale televizive? Cili është intelektualiteti dhe kreativiteti i një lexuesi dhe cili i një shikuesi? Ndërsa një analfabet mund të rrijë tërë ditën duke shikuar storie televizive apo edhe i kyçur në internet, një lexues nuk mund të bëjë këtë, mbasi po qëndroi dhe mbajti afër librin, ai

vetëm do të shohë vija të përafërta dhe të zeza, siç janë zakonisht shkronjat në pjesën dërrmuese të botimeve. Mekanizmi i programimit dhe i kontrollit të një lexuesi serioz është shumë funksional, përkundër një shikuesi joserioz. Madje, kur bëhet fjalë për seriozitetin e konsumuesit, lexuesi patjetër do të shfrytëzojë një përmbajtje libri, ndërkohë që një shikues apo edhe dëgjues radioje e ka shumë më të lehtë, sepse koncentrimi dhe mekanizmi i programimit, nuk ia vlejné të jenë ngaherë në veprim, një shtrëngim dhe koncentrim ky serioz për të komunikuar me shkrimin.

Libri të shpesh të ka një konsumues paraprakisht të caktuar. Literatura për nxënës apo për studentë kryesisht konsumohet nga nxënës dhe studentë, madje shpesh u dedikohet edhe klasave, përkundër televizionit që synon, siç vëren Lorimer, publik të papërcaktuar. Lexuesi gjendet në pozitë të zgjedhë, përkundër shikuesit, i cili nuk mund të zgjedhë shumë, sepse ka të bëjë me një objekt - institucion të imponuar brenda shtëpisë apo dhomës së tij.

Televizioni nuk prejudikon kërkesën për kontrollim të sjelljes, libri është shumë më konservator dhe tradicional. Ndryshe, nuk është se libri ka pasur një imunitet të përhershëm për të krijuar qëndrime agresive dhe johumane tek ata që e kanë konsumuar, por veprimi i tij ishte shumë i kufizuar. Dëmet mbërrinin në individë apo edhe tek ndonjë grup jo fort i madh. Libri nuk mund të fajësohet për një qëndrim kolektiv agresiv të një grupi social apo etnik, por e kundërta ndodh me televizionin. Është i njohur në komunikologjinë moderne nocioni telediktaturë si

paraprijëse apo mbajtëse - mbështetëse e diktaturës. Asnjë diktaturë nuk mund të mbijetojë pa telediktaturë së pari dhe pastaj edhe pa mediadiktaturë. Të mos harrohet, televizioni kultivon dhe ndërton qëndrime kolektive, veçmas kur nuk ekziston një rrjet policentrik, duke e kthyer kështu mesazhin themelor në ideologji ekstreme, nacionaliste, raciste etj.. Rreth librit të caktuar bëhet zhurmë, pa pasur mundësi reaksioni, por media nxit dhe krijon vetë zhurmë, e modelon volumin, përmbajtjen dhe gjerësinë e saj. Rreth librit krijohet një kaos kulturor i kufizuar publik, nga media krijohet një kaos i pakufizueshëm publik. Shkrimi-libër na del në një proces të krijimit të jetës së njeriut, ndërsa media jep modelin e rikonstruksionit të jetës së njeriut. Libri motivon më shumë pretexte që njeriu të mendojë për vete, më thellë të shohë arsyet e gjendjes dhe pozitës së vetë, ndërsa televizioni shton oreksin e publikut për t'u marrë, pastaj të mendojë për problemet e të tjerëve, shumë shpesh fare të parëndësishme dhe të panevojshme, duke dashur të harrojë vetveten. Në këtë kontekst, Bodrie, krijon një tezë më radikale: Nuk ka më subjekte, nuk ka më periferi dhe as qendër, njëkohësisht ndodh impulsimi i mesazhit dhe i mediumit, impulsimi i mendimit në realitet në një formë nebuloze ireale. Përderisa në aspektin psikologjik, televizioni krijon individë të automatizuar, në kuptimin social ai ndikon që të krijohet aglomerat i papërmbajtje (pa cilësi), ndryshe thënë, krijon masën, turmën që është e vetmuar, quajtur ndryshe nga Bodrie si - rizmane. Pra, në një mënyrë thuajse të prerë, Bodrie është njëri nga përfaqësuesit më të

njohur të tezës sipas së cilës mediat nuk janë krijuar të socializimit, por saktësisht e kundërta, implusim i masës shoqërore.

Mediat në përgjithësi kanë prirje të krijojnë vlera dhe të nxisin krijimin e kërkesave të reja të publiku, ndonëse publiku nuk ka mjete që ato kërkesa t'i realizojë. Në këtë kuptim, televizioni shndërrohet në një prodhues të frustrimeve kolektive. Kjo mund të shkaktojë edhe *deprivacitetin relativ*, mbasi publiku nuk e mbërrin atë që është e pambërritshme, në realitet. Ky raport disfunksional nuk mbetet vetëm në nivelin e televizionit dhe individit apo të publikut lokal. Shtrirja e këtij raporti përmes televizionit, por edhe përmes mediave të tjera, bartet edhe nga një vend në vendin tjetër. Madje edhe shumë qeveri të vendeve në krizë, pretendimet i kanë më të mëdha dhe të porealizueshme duke u gjetur nën presionin e mediave të huaja, mbasi provojnë si burim matjeje të forcës së tyre, vendet e zhvilluara. Shumë projekte të dështuara dhe improvizime politike dhe ekonomike në vendet në tranzicion, me trendin e imitimit banal të arritjeve dhe veprimeve të vendeve të zhvilluara, bëhen nën ndikimin e përmbajtjeve mediale që janë shkak kryesor i këtij disproporcioni ndërmjet realitetit dhe irealitetit. Daniel Lerner, në këtë kontekst, vlerëson, se në shumë vende krijohen projekte të gabuara të zhvillimit social dhe ekonomik, duke provuar të imitohen vendet e zhvilluara. Nga kjo filozofi krijohet edhe konsumim pa mbulesë në shoqëritë e tranzicionit, në vend që kjo filozofi të orientohet në kursime, apo në prodhimin dhe krijimin e vlerave

që janë reale dhe përkatëse me atë publik.

Libri e ngrit pyetjen - pse? Televizioni provon të na bindë se nuk ekziston pse-ja, nuk është e nevojshme të ngrihet pyetja - pse. Të gjitha përgjigjet janë të dhëna në përmbajtjet e shumta mediale.

Shkrimi-libër ndihmon njerëzit të mësohen të mendojnë për botën, gjuha e tij paraqet kryesisht sistem, (strukturë dhe praktikë) përmes: sintaksës, semantikës dhe pragmatikës. Gjuha e librit ndikon në përhapjen e shkrimit dhe të leximit, u krijon hapësira shumë më të mëdha grupeve dhe popujve të standardizojnë të folurit dhe të shkruarit. Televizioni i mëson dhe i drejton njerëzit të komunikojnë me botën. Gjuha e televizionit është gjuhë e shtresimeve të ndryshme dhe grupeve sociale, etnike, me mundësi të pluralitetit gjuhësor.

Në parimin e përkufizimit të Eliotit për kulturën, libri shtyn të kërkohet përgjigja çfarë e bën jetën e njeriut të vlefshme, ndërsa televizioni në këtë kontekst, do të thoshim se, jep versionin e vet për mundësinë e jetës së njeriut në mënyrë interesante, pa kërkuar një dimension më të thellë arsyeje.

Duke ecur tutje, mund edhe të ngrihen pyetje më dramatike? Libri dhe media a janë në të vërtetë një, e njëjta çështje në këtë dallim të madh? Libri është vetë media dhe media është thelbi i librit. Sa ia vlen të kërkohen dallimet? Njeriu ka shanse të jetë larg tyre, të jetojë pa librin dhe median, mund të jetë madje edhe i lumtur. Ai edhe mund të heq dorë prej tyre, sepse ia krijoi vetes ato, prandaj është në gjendje të heqë dorë ndonjëherë nga ajo që e ka krijuar, qoftë të kenë ato krijime një funksion qind

për qind të mirë. Po ai shpesh ka ngritur shumë lloj akuza dhe sharje për librin dhe televizionin se ia kanë ndotur ambientin, qetësinë ia kanë shkatërruar, dhe vetë atë e kanë shndërruar në një ishull të braktisur personal, duke e lënë bosh në një lokalitet të frikshëm dhe konfuz, shpesh edhe të pavullnetshëm bioantropologjik. Do njeriu një largim edhe fizik edhe intelektual, pra edhe shoqëror, madje nga ato të riprojektuara gjithçka - emocione, shqisa, estetikë.

Se miliarda njerëz jetojnë vetëm duke konsumuar përmbajtje televizioni, ky është një fakt i madh, po miliarda njerëz konsumojnë njëkohësisht edhe librin edhe përmbajtjet televizive. Gjenden pak fare, që në jetën e tyre udhëtojnë vetëm me librin, pa mediat, apo pa të dyja bashkë. Libri konsiderohet një vlerë tradicionale-konservatore, kulturore dhe civilizuese, sa do që është shumë moderne dhe në ditët e sotme. Televizioni e ka një kuptim civilizues dhe kulturor, por jo edhe aq tradicional-konservator. Teknologjia komunikuese vlerësohet nga komunikologët të jetë teknologji e civilizimit, kurse kundërshtarët ngrenë zërin se është teknologji e dehumanizimit. Ndërsa më parë civilizimi njerëzor identifikohet shumë me librin, me shtrirjen e tij, me biblioteka dhe librari, civilizimi i sotëm nuk identifikohet gjithaq më me librin, por me median. Shkrimi është vetëm një segment i vogël i civilizimit, ndërsa media është totaliteti i civilizimit të sotëm botëror, pa mënjanuar shkrimin.

Kur më 1987 u botua libri i parë kompjuterik i Majkëll Xhojsit "Mbrëmja", nisi epoka e re, duke i shtuar librit elementin interaktiv.

Raporti libri në njërin anë dhe kompjuteri - interneti në tjetrën, hap dilemën e së ardhmes estetike dhe antropologjike të librit që nuk do të thotë të jetë apriori krizë dhe reduktim i estetikës në favor të teknologjizmit dhe aventurës, por nga pozita e sotme se çka do të ndodhë vërtetë, nuk është lehtë e paparashikueshme.

LITERATURA:

Achille Y., Bueno, Ibanez.: "Les televisions publiques en quete d'avenir", Grenoble: Presses, 1994

Albert. P: "Histoire de la presse", Paris, 1970

Axel Buchholz, Gerhard Schult: "Gazetaria televizive", KB, Tiranë, 2002

Charles, Lalo: "L'art et la vie sociale", ed. G. Doin, Paris, 1986

Denis McQuail: "The Influence and effects of mass media", Media Powr in politics", CQPRESS, Washington, D.C. 2000

Dërvishi, Zuvdi: "Sociologjia e kulturës I", Tiranë, 2001

Kaznev, Zhan: "Sociologjia radio-televizije", BIGZ, Beograd, 1976

Lorimer, Rolend: "Masovne komunikacije", Clio, Beograd, 1998

Marshall McLuhan: The Global Village: Transformations in World Life and Media in the 21st Century *with Bruce R. Powers (Oxford University Press), 1989

Novosel, Pavao: "Informiranje i komunciranje u velikoj gradskoj aglomeraciji", IPN, Zagreb, 1987

Stipçeviq, Aleksandër: "Historia e librit", Rilindja, 1988

Stipçeviq, Aleksandër: "Censori i përsosur", Era, Prishtinë, 2003

Unzeld, Zigfrid: "Autor i njegov izdavac", Jedinstvo, Prishtinë, 1990

Grup autorësh: Si të lexohet", Art Club, Ulqin, 1996

HISTORIA GOJORE DHE KUJTESA E KOSOVËS

GJON BERISHA

Një iniciativë e nisur disa vite më parë nga Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës për ta mbledhur dhe prezantuar kujtesën historike të Kosovës, të titulluar si “*Kujtesa e Kosovës*”, sipas modelit të Bibliotekës së Kongresit Amerikan të quajtur “*American Memory*”, aktualisht gjendet në suazën e krijimit të një koleksioni me materiale të shtypura (libra, broshura, harta, fotografi).

Një nga format që do t'i ndihmonte dhe do ta pasuronte këtë projekt është edhe mbledhja, sistemimi dhe publikimi e materialeve në formatin multimedial në ueb-faqen e bibliotekës (incizime me zë, videoklipe) të historisë gojore.

Ç'është historia gojore?

Historia gojore është një dokumentim dhe analizë e disa prej kujtimeve të shkuara të treguara dhe përfshin dëshmitë e dëshmitarëve okularë në një ngjarje të caktuar. Historia gojore është “thjesht njëri nga mjetet, që ndihmon njerëzit të komunikojnë me njëri-tjetrin” dhe në të njëjtën kohë “një instrument për mbledhjen e të dhënave”. Si rezultat, metoda e mbledhjes së historisë, e cila përfshin edhe tregimet e dëshmitarëve, ka marrë emrin sipas termit Amerikan “*Historia Gojore*” (“*Oral History*”), e cila ruan gjurmët e aktiviteteve të përditshme, dëshmitë e njerëzve të ndryshëm rreth përvojave të tyre, ndjenjave dhe qëndrimeve të tyre për ngjarje të shkuara, të cilat ata i kanë vëzhguar apo kanë marrë pjesë në to.

Historia gojore është një përshkrim i diçkaje e që përcillet gojarisht nga një

brez në tjetrin. Përvoja në kultura të ndryshme ka treguar se sa herë që një histori apo një kujtim prezantohet, mund t'u nënshtrohet disa ndryshimeve, edhe pse thelbi i historisë apo kujtimit ruhet gjithnjë.

Ndonjëherë ndodh që një histori mund të pësojë ndryshime të vogla graduale deri në pikën e ndryshimit të të gjithë historisë apo kujtimit, derisa ato nuk mund të njihen më në versionet e mëparshme. Në të vërtetë, historia gojore është dokumentimi dhe analiza e dëshmimeve të shkuara të rrefyera dhe një proces formal dhe informal i mbledhjes së të dhënave historike gojore dhe i paraqitjes së një dimensionit të ri e të kuptueshëm të historisë kombëtare, të historisë së shoqërisë si dhe të historisë së familjes dhe individit.

Historia gojore është një metodë ndërvepruese, e cila u jep njerëzve mundësinë të paraqesin dhe ndajnë në një komunitet më të madh disa fakte politike, sociale apo historike, të cilat kanë qenë të paditura për publikun, për të kuptuar historinë dhe për t'u përballur me të.

Përdorimi i historisë gojore për të ndërtuar një histori kombëtare ofron një model më koherent, të besueshëm dhe të qartë të kontekstit të së shkuarës, i cili përcillet shumë qartë në ditët e sotme. Historia gojore i lejon njerëzit të trajtojnë vështirësitë e tyre të jetës në një mënyrë, që nuk mund të komunikohet në një kontekst tjetër.

Një mjet i rëndësishëm i historisë gojore është teknika e intervistimit, e cila ndihmon në zbulimin e informacioneve personale të njerëzve,

të cilët kanë kontribuar në ndërtimin e historisë. Gjithashtu duhet thënë se çdo intervistë është unike dhe çdo intervistues zbulon njohuri të veçanta lidhur me ngjarje të ndryshme historike. Historia gojore mund të përdoret në kategori të ndryshme historike, sociale, ekonomike dhe politike, duke pasuruar mënyrën e të kuptuarit të një vendi apo rrethi të caktuar. Edhe pse historia gojore zhvillon informacionin, i cili nuk është regjistruar në një formë të shkruar, në shumtën e rasteve vihet në pikëpyetje besueshmëria e informacionit. Pikërisht për këtë arsye sigurimi i materialeve nga ana e BKUK-së, të mbledhura përmes intervistës, si teknikë e historisë gojore, duhet t'i nënshtrohet të njëjtit test besueshmërie si burimet e tjera të përdorura për të krijuar historinë kombëtare apo historinë shoqërore, me qëllim që të përftohet një dokumentim më bindës dhe më autentik. Ajo mund të përmbajë një shumëllojshmëri të formave, duke u fokusuar në:

marrjen e njohurive të së kaluarës që kanë kaluar gjeneratat e mëparshme (tradita gojore);

tregimin e ngjarjeve sipas përvojës personale që ka ndihmuar në formimin e asaj jete dhe të japë kuptimin për të (një biografi gojore);

kujtimet personale të individëve mbi ngjarjet, çështje dhe përvojat e sigurta që kanë kaluar në të kaluarën e tyre;

dëshmitë gojore të regjistruara gjatë apo menjëherë pas ngjarjes (përshkrimet e dëshmitarëve).

Që intervista të jetë e suksesshme, nevojitet përgatitja paraprake. Kështu,

një intervistues duhet të ketë parasysh disa gjëra para se të shkojë në një intervistë:

Të kryejë një hulumtim të literaturës ekzistuese për temën e intervistimit për të kuptuar aspektin shoqëror/historik dhe për të përpiluar një pyetësor për intervistën;

Të zgjedhë me kujdes të intervistuarit bazuar në synimet e intervistës së historisë gojore;

Të marrë paraprakisht miratimin e të intervistuarit apo, në rastin e fëmijëve, të marrë miratimin e prindërve apo kujdestarëve të tyre para kryerjes së intervistës;


Të kontrollojë paraprakisht të gjitha pajisjet teknike të nevojshme për intervistën magnetofonin (zakonisht kontrollohet për energjinë elektrike dhe bateritë);

Të jetë i ndershëm, i devotshëm, t'u përgjigjet pyetjeve dhe të jetë fleksibel gjatë intervistimit;

Më e rëndësishme nga të gjitha, të jetë vëzhgues gjatë gjithë procesit të intervistimit për të kuptuar se çfarë është më e rëndësishme për intervistën dhe informacionin e marrë dhe të mbushë boshllëqet e burimeve ekzistuese të shkruara.

Procesi i historisë gojore nuk është një proces i izoluar dhe përfshin një tërësi procedurash të rëndësishme. Në rastin e BKUK-së, një iniciativë e tillë duhet të realizohet përmes një projekti të detajuar, i cili mund të realizohet në tri faza.

Në fazën e parë, do të organizohet një punëtori (trajnim) brenda bibliotekës në të cilën pjesëmarrësit (disa punonjës të BKUK-së dhe disa studentë të angazhuar) do të mësohen, të marrin intervista nga dëshmitarë të një kohe. Faza e dytë, do të përfshinte procedurën e përzgjedhjes tematikës dhe periudhës kohore me interes, zgjedhjen e personave për t'u intervistuar; procedura e përpilimit të pyetësorëve të intervistës si dhe intervistimi i banorëve rezidentë në terren. Tematika e



mbledhjes së kujtesë përmes intervistës, mund të organizohet sipas shembujve të ndryshëm: p.sh.: *“Ilegalja në Kosovë pas Luftës së II Botërore”*, *“Ndryshimet kushtetuese në vitet 60-ta”*, *“Demonstratat e vitit 1968”*, *“Hapja e Universitetit të Prishtinës 1970”*, *“Ndryshimet kushtetuese në vitin 1974”*, *“Demonstratat e vitit 1981”*, *“Sistemi arsimor në Kosovë në vitet 90-ta”*, *“Kosova gjatë rezistencës paqësore të viteve ‘90-të”*, *“Lufta e UÇK-së”*, *“NATO në Kosovë”*, *“Kosova nën kontrollin ndërkombëtar të UNMIK-ut”*, *“Kosova pas shpalljes së pavarësisë dhe njohjes ndërkombëtare të saj”* etj.

Në fazën e tretë, incizimet audiovizuale të mbledhura nga kujtimet e intervistave transkriptohen, nganjëherë përkthehen, analizohen, raportohen, përpunohen sipas tematikave dhe më pas arkivohen apo publikohen në ueb-faqen e bibliotekës. Në këtë ueb-faqe mund të shihen video filma të shkurtër me njerëz të cilët tregojnë kujtimet e tyre për një kohë të caktuar.

Meqë historia gojore si metodë e mbledhjes së kujtesës historike, është e përshtatshme për periudhën e historisë bashkëkohore, përkatësisht vetëm nga rrëfimet e dëshmitarëve të gjallë, ajo mund të përfshinte përafërsisht

periudhën nga vitet 50-ta të shekullit XX e gjerë te lufta e fundit e UÇK-së në Kosovë.

Historia gojore synon të përdoret për dy qëllime kryesore. I pari është të ndihmojë të ndërtojë të kaluarën; të nxjerrë çfarë ndjente një ushtar i zakonshëm i UÇK-së në transhe gjatë luftës, ose një refugjat i dëbuar nga Kosova. I dyti është të ndihmojë për të kuptuar se si njerëzit interpretojnë të kaluarën. Burimet gojore na tregojnë jo vetëm se çfarë njerëzit bëjnë, çfarë ata dinë dhe çfarë ndodh me ta, por gjithashtu ato tregojnë se çfarë njerëzit mendonin, ndjenin dhe besonin në atë kohë, çfarë ishin duke bërë dhe përse, çfarë ata donin të bënin dhe çfarë ata mendojnë tani për ato që kanë bërë dhe për njerëzit e tjerë.

Mbledhja dhe begatimi i koleksionit *“Kujtesa e Kosovës”*, me materiale të mbledhura përmes metodës së historisë gojore, do të krijonte mundësi që përdoruesi i bibliotekës në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin vend të vërë përballë të gjitha burimet historike të shtypura (dokumentet, librat, fotografitë) me ato të rrëfimeve gojore në format video-incizim, të bëjë analizën e tyre dhe të nxjerrë rezultatet e nevojshme.

KLASIFIKIMI I BIBLIOTEKAVE DHE KLASIFIKIMI NË BIBLIOTEKA

JEHONA SHALA

Qendra më e madhe e grumbullimit dhe e ofrimit të librit te lexuesi vazhdon të mbetet biblioteka, e cila tashmë i ka venë vetës detyrën e përcimit të informacionit nga shkruesi te lexuesi. Duke u kuptuar gjithnjë e më shumë rëndësia dhe roli i fuqishëm që biblioteka ka brenda një shoqërie, apo komuniteti, ka bërë që me kalimin e kohës bashkë me zhvillimet gjithnjë e më të mëdha shoqërore të arrihet deri te prurjet e reja në “ndërtimin” dhe zhvillimin e bibliotekave, prurje që ofruan gjetje gjithnjë e më adekuate për vendosjen e librit në vendin e duhur, që çdo herë shkon në favor të lehtësimit të praktikave të vendosjes dhe gjetjes/huazimit, gjë që sot rezulton me ndarje të bibliotekave në lloje të ndryshme, dhe me perfeksionim të klasifikimit si domosdoshmëri për përcaktimin e “vendit” të secilit libër apo çfarëdo materiali bibliotekar qoftë. Disa nga llojet e bibliotekave që sot njihen, janë ato nacionale, universitare, komunale, shkollore etj. Lloje këto që janë të mbuluara nga qasja kolektive, pra duke përjashtuar kështu bibliotekat personale të cilat edhe nga vetë emërtimi e nënkuptojnë zgjedhjen, vendosjen dhe qasjen individuale.


Ky zhvillim dhe kjo ndarje ka krijuar kushte të favorshme për përzgjedhjen e materialeve përbërëse të secilës bibliotekë, për plotësimin e fondeve në përshtatshmëri me emrin

që mbajnë dhe me kërkesat e lexuesve të mundshëm.

Kështu, biblioteka kombëtare mori detyrimin e krijimit të një hapësire për librin që vëmendje të posaçme i kushton nacionit, për t’ia lënë bibliotekës universitare “barrën” e pasurimit të fondeve në përputhshmëri me kërkesat universitare, vend që ka marrë konturat një *mësimdhënësi* kolosal. Bibliotekat komunale morën përgjegjësinë e ofrimit të leximit të llojllojshmërisë së materialeve në përshtatshmëri me kërkesat e qytetarëve duke mbuluar kështu moshën dhe formimin të ndryshme. Ndërsa në ndjekjen e linjës së programeve mësimore mbeten bibliotekat shkollore.

Rritja e fondeve dhe e llojeve të bibliotekave bëri që profesionalistët përpunues të librit të bëjnë një numër të konsiderueshëm zgjidhjesh për përcaktimin lëndor/tematik të secilit libër veç e veç, zgjidhje kjo që sot ka ofruar lehtësim të madh për vendosjen e librit në raftet si dhe gjetjen me lehtësi përgjatë procesit të huazimit, dhe kjo “zgjidhje” në gjuhën e bibliotekarisë sot njihet me emrin klasifikim. Klasifikim ky që ekziston në më shumë se në një mënyrë, por duke pasur si referencë të njohjeve praktike të këtyre klasifikimeve Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, marrim në konsideratë vetëm ato klasifikime që kjo bibliotekë sot përdor. Tani për tani aplikon dy nga këto klasifikime numerike, siç janë KUD-i (Klasifikimi Universal Decimal) dhe klasifikimi me Cutter (emër që ka marrë sipas mbiemrit të përpiluesit të

klasifikimit). Duke lënë anash këtu fondet e bibliotekës kombëtare pasi që vendosjen e librave në raftet nuk e bëjnë në bazë të numrit të klasifikimit por në bazë të numrit rendor të arritjes së librit në bibliotekë, do të shohim rëndësinë e vendosjes së numrit të klasifikimit në librat e QBU-së (Qendra e Bibliotekës Universitare). Fondet e së cilës, që janë të ndara deri tani në tri koleksione të ndryshme si KLM (Koleksionet e Lëndëve Mësimore), KP (Koleksioni i Përgjithshëm) dhe REF (Koleksioni Referal), i aplikojnë të dy këto mënyra klasifikimi dhe për t’u vendosur libri i cilitdo koleksion në vendin që i takon duke u bërë kështu obligim vendosja e numrave të klasifikimit. Librit përgjatë përpunimit i vendoset numri i KUD-it që është treguesi për lëndën/përmbajtjen tematike të librit, duke i shtuar këtij numri edhe numrin e dytë klasifikues që zbatohet sipas tabelës së Cutter-it, tabelë kjo që udhëzon shënimin e germës së parë të mbiemrit të autorit dhe tri gërmat e radhës së mbiemrit shënohen me numra të përcaktuar nga vetë kjo tabelë ku respektivisht secila gërmë ka numrin e saj identifikues. Dhe këtyre dy klasifikimeve, të parit tërësisht numerik, të dytit alfabetik e numerik së bashku, i shtohet edhe një identifikues i tretë që është viti i botimit të librit. Ky klasifikim që është edhe anë e jashtme për pasqyrimin e përmbajtjes së librit, meqë kjo përbërje e klasifikimit është e vendosur si etiketë në secilin libër, e mundëson vendosjen e lehtë të librit në raftet, dhe në të njëjtën kohë, lehtëson arritjen e lexuesit deri te libri



i dëshiruar, në rast se aplikohet mundësia e huazimit pa shumë ndërmjetës ose vetë huazimit, siç ekziston në shumë biblioteka në vende të ndryshme, gjë që do t'i shkonte shumë përshtati bibliotekës universitare, meqë është bibliotekë me fond të hapur, duke kursyer kështu edhe kohën e bibliotekarit edhe kohën e lexuesit respektivisht studentit a profesorit. Lehtësia qëndron duke filluar prej ndarjes së lëndës, meritë e cila i takon KUD-it, dhe si rrjedhojë librat e një lëmi, ta zëmë librat nga letërsia, gjenden të vendosura afër njëra-tjetrës në raftet, pastaj për lehtësim të dytë është numri i Cutter-it, që është jo identifikuesi për lëndën, por identifikuesi për vetë autorin (identifikues ky i përshtatshëm vetëm për bibliotekarin, sepse për lexuesin që nuk i njih rregullat e klasifikimit do të krijojë paqartësi kur gjendet përball rafteve me libra), duke iu shtuar kësaj edhe vendosja e vitit të botimit të librit ku pason radhitja me nismë nga

botimet me të hershme. Rëndësia e klasifikimit të librit universitar qëndron te kjo pikë, pasi që nga kjo varet radhitja, dhe, klasifikimi i gabuar e nxjerr edhe radhitjen e gabuar, dhe radhitje e gabuar për librin d.m.th humbje. Ndërsa gjithë zhvillimet në fushën e bibliotekarisë njërin ndër objektivat primare e kanë vendosjen e librit në vendin përkatës, me ç'rast janë formuar edhe lloje të ndryshme katalogësh elektronik, që me gjithë perfeksionimet e mundshme elektronike, qëllimi i tyre mbetet krijimi i kushteve sa më të favorshme për të dhënat mbi librin, duke e ndërlidhur kështu edhe numrin e radhitjes qoftë ai i signaturës, apo radhitje me klasifikim, prapëseprapë të gjitha këto shkojnë ndër të tjera edhe në dobi të saktësisë së vendosjes së librit në raftet, dhe lehtësisë së ofrimit për lexim. Krijimi i mundësive për vendosje dhe huazim sa më të lehtë nga ana e mjeteve të ndryshme elektronike, bazën e sigurisë vazhdon ta ketë jo në

perfeksionimin e programit, por në kujdesin e bibliotekarit për të dhëna korrekte duke e pasur në mendjen e tij gjithmonë detyrimin që ka ndaj lexuesit prej momentit të pranimit të përgjegjësisë profesionale. Dhe duke pasur në mendje gjithnjë lexuesin, duke kërkuar në raftet e bibliotekës, siç edhe duhet të ndodh në një të ardhme të afërt në bibliotekën universitare, bibliotekari duhet të kujdeset jo të ngjall habi por qartësi për lexuesin. Mendim ky për qartësinë që kërkon rishqyrtim të vendosjes së klasifikimit të Cutter-it dhe ndonjë zëvendësim eventual p.sh. sikur në vend të numrave të tabelës së Cutterit të vendosej mbiemri i plotë i autorit, gjë që përdoret në pjesën më të madhe të bibliotekave universitare në botë, ndoshta do të krijonte lehtësi me të madhe për lexuesin, meqë domosdo e gjithë puna në biblioteka të çfarëdo lloji qofshin ato, bëhet për lexuesin, qoftë ky lexuesi i tashëm apo i pritshëm.

HARTOGRAFIA DHE HARTAT

(Evidenca dhe kontekste)

MUHARREM HALILI

HISTORIKU I HARTOGRAFISË

Hartat, atlaset, globet, e auto-hartat për ne janë vegla të përdorimit të përditshëm. Si erdhën njerëzit deri tek ajo që të skicojnë sipërfaqen e tokës?

Historia e hartografisë është njësoj e vjetër sikur edhe historia e civilizimit njerëzor, ajo pasqyron pushtimin e tokës nga ana e njeriut. Që nga lashtësia njerëzit kanë provuar që t'i vizatojnë disa pjesë më të theksuara gjeografike. Me vizatimet, të cilat i gdhendnin në gurë, eshtra, brinjë, iu lehtësohej atyre orientimi gjeografik. Dokumentet më të vjetra hartografike të mbetura janë pllaka argjili që datojnë nga viti 3800 p.e.s. dhe vijnë nga Mesopotamia. Harta botërore më e vjetër e mbetur dhe e vetmja rrjedh nga kohët e vona të Babilonisë rreth 2500 vjet p.e.s. Kjo hartë është po ashtu e gdhendur në argjil. Përdorimi i hartës dhe matja e hapësirës në Egjipt zuri vend diku rreth 2000 vjet p.e.s. Në këtë kohë është e njohur harta e botës.

Nga erdhi nocioni hartë? Disa ua lënë grekëve, disa të tjerë thonë se e ka prejardhjen nga fjala portugeze "cartas" = letra. Kjo fjalë nga Spanja mori rrugën në Itali dhe është kombinuar me fjalën greke chartys dhe sjellë fjalën e re latine "charta". Nocioni "charta" u përhap në tërë botën. Termi gjerman "Karte" është hasur për herë të parë në shek. e XVI. Hartografët grekë përpunuan hartën me parametra shkencore përmes projekteve të para. Hartën greke për botën i pari e solli Anaksimandri, e cila nuk është ruajtur. C. Ptolemeu rreth vitit 150 vizatoi hartën botërore, harta të pjesëve të tokës dhe vendeve të caktuara. Kopja

më e vjetër e ruajtur është nga shek. XII. Ptolemeu me punën e madhe gjeografike zuri vend në përjetësi. Më shumë se një milenium sistemi i tij ishte i pazëvendësueshëm, me gjithë lëshimet - gabimet që i kishte, ai paraqet bazën e zbulimeve gjeografike deri në ditët e sotme. Megjithatë, 6 shekuj para Ptolemeut, Pitagora njohu që toka është e rrumbullakët. Matematikanët dhe filozofët e shkollës së madhe të Pitagorës i njihnin lëvizjet e tokës me anë të vëzhgimit dhe matjeve. Fatkeqësisht kjo njohuri prapë u la në harresë. Më shumë se një milenium pas Ptolemeut, asnjë shkencëtar nuk e vinte në dyshim që toka ka formë tjetër, përveç se formë disku - rrumbullakët. Erastosteni i Krienes përpiloi hartën e botës antike me shkallë të gjerësisë dhe gjatësisë gjeografike. Hartografia romake ishte zhvilluar mjaft dhe bazohej në parime praktike: harta rrugore, harta botërore në formë të rrumbullakët dhe matje të pjesëve të largëta. Për romakët më me rëndësi ishin rrugët, rregulli dhe ligji se sa e vërteta se çfarë forme apo madhësi ka toka. Në mesjetë, hartografisë iu kushtuan posaçërisht arabët. Hartografia arabe bazohet në teorinë e Ptolomeut mbi tokën. Gjeografia e Ptolomeut ishte përkthyer në shek. e VIII. Dituria arabe në shekullin e X arrin kulmin e zhvillimit të saj. Në këtë kohë na paraqiten Albateni dhe Masudi të cilët dhanë kontribut të madh në astronomi dhe kozmografi. Në shekullin e XII dituria arabe është rrumbullakuar nga Alberuni në lindje dhe Idrizi në perëndim. Hartën e botës në bazë të studimeve të Alberunit e ka paraqitur Ibn-Kaukali, e cila është shumë e njohur për botën Arabe. Në

botën perëndimore Idrizi është hartografi më i njohur Arab i cili në pleqëri u vendos në Palermo të Italisë, ku vazhdoi punën e tij me sukses. Ndër hartat më të njohura të Idrizit është Harta e botës, e cila u përfundua në vitin 1154. Hartografinë arabe në Evropë e solli K. Milleri me botimin e hartës Mappae Arabicae, dy nga këto harta përfshijnë territore shqiptare - Kosovën. Shumica e hartave në manastire të perëndimit nuk sollën ndonjë përparim. Perëndimi i krishterë ishte plotësisht i kthyer nga ideale të tjera. Njeriu mesjetar lidhej ngushtë për besimin e tij. Të gjithë shkencëtarët duhej t'i ruheshin besimit të kishës. Progresi filloi me udhëtimet detare të shek. XV.

KOLEKSIONI I HARTAVE DHE ATLASEVE NË BKUK

Koleksioni i hartave në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës ka ekzistuar që nga themelimi, mirëpo formën dhe konturat i merr me kalim në objektin e ri më 1981. Koleksioni është formuar duke zgjedhur materialet nga fondi i përgjithshëm, nga grumbullimi i ekzemplarit të detyrueshëm si dhe nga dhuratat të dhuruara nga institucione të ndryshme dhe individë, por edhe nga blerja.

Në këtë koleksion grumbullohen, përpunohen, ruhen, ofrohen informacione të plota si dhe jepen në përdorim në BKUK nën mbikëqyrjen e bibliotekarit. Ky koleksion përpunohet dhe sistemohet në vijimësi, posedon katalogun special, si dhe është pjesë përbërëse e katalogut përmbledhës.

Kujdes i posaçëm i kushtohet fondit kombëtar, ekzemplarit të detyrueshëm, si dhe atij të vjetër dhe të rrallë. Hartat

janë burime shkencore, informata aktuale, pasqyrë e lëvizjeve historiko-politike, me vlera historiko-artistike, si dhe vlera estetike. Gjatë hulumtimit të lëvizjeve apo fenomeneve shoqërore në kohë dhe hapësirë, materialet hartografike kanë rëndësi të posaçme. Sektori i hartografisë u ofron shërbime dhe informacione punëtorëve shkencorë dhe përdoruesve të tjerë të Bibliotekës.

PËRMBAJTJA E KOLEKSIONIT TË HARTAVE

Ky koleksion përbëhet prej hartave të llojeve të ndryshme, si p. sh. hartave fizike, topografike me dimensione të ndryshme, hartave gjeologjike, detare, klimatike, etnografike, politike etj.; pastaj hartat në dorëshkrim, hartat astronomike, si dhe të gjitha llojet e atlaseve dhe planeve të qyteteve dhe viseve të ndryshme.

Fondi i hartave është i sistemuar dhe ndërtuar me harta nga të gjitha viset e botës, duke filluar nga harta e Botës, hartat e kontinenteve, në veçanti ato të Evropës. Dominojnë hartat e Ballkanit, Evropës Juglindore, hartat e Mesdheut e posaçërisht hartat ku paraqiten trojet Shqiptare.

Koleksioni i hartave, që përfshin territoret shqiptare nuk është aq i pasur aq sa i hartave të vendeve të rajonit. Kosova paraqitet në përbërje të tërësive gjeografike të rëndësishme, por si pjesë periferike e hartës.

Harta më e hershme, më e vjetër, me të dhëna gjeografike për territore shqiptare – Kosovën, është punuar në kohët antike nga babai i hartografisë Ptolomeu, i cili në mënyrë pitoreske paraqet skeletin trekëndësh malor, dy lumenj, gjashtë vendbanime dhe kufijtë e provincave. Gjatë kohës së mesjetës hartografimi i trevave tona ka qenë i varfër.

Hartografimet e para reale të territoreve tona, që kanë rëndësi të posaçme janë bërë në shek. e XV, duke filluar nga Roselli, i cili shënon katër lumenj tri vendbanime, nga të cilat një është real, ndërsa dy të tjerat kanë të

bëjnë me emërtimin e visit gjegjësisht lumit. Kjo ide përvetësohet dhe zgjerohet më vonë nga Benvenutoja, Gastaldi, Bertelli e Merkatori.

Harta e parë i është bashkangjitur si moderne "Gjeografisë" së Ptolomeut, ndërsa ajo e fundit gjendet në koleksionin e parë të hartave të quajtur "Atlas". Vlerë të veçantë paraqesin hartat dhe Atlaset e vjetra e të rralla të Ptolomeut, Stradonit, Ortlus, Mercatorit, Mueller, Fischbach, Coronelli etj. Shumica e këtyre hartave janë të reprinted, disa prej tyre i posedon BKUK.

Hartografimin e trojeve tona në shek. e XVIII e karakterizon një amull për shkak të mbylljes së Perandorisë Turke. Autorët e ndryshëm s'kanë arritur të depërtojnë në territoret e Perandorisë turke dhe të sigurojnë burime të besueshme, kështu që punimet e tyre hartografike i kanë bazuar në burimet klasike.

Nga periudha e Perandorisë Turke duhet veçuar hartat në dorëshkrim të territoreve shqiptare të ndara në Vilajete: Vilajeti i Kosovës, Vilajeti i Prisenit, Vilajeti i Shkodrës, Vilajeti i Manastirit dhe Vilajeti i Epirit.

Më karakteristike është Harta e rrugëve dhe traseve në Vilajetin e Prisenit, nga autori Fischbach e vitit 1870, që përmban rrugët e reja, trasetë dhe urat ku janë shënuar lagësitet prej një vendbanimi deri te tjetri dhe janë shumë të sakta - pothuaj të njëjtë me lagësitet e sotme.

Në fund shek. XVIII ndërrojnë rrethanat dhe paraqiten pasardhës të hartave më precize të punuara nga vëzhgimet e drejtpërdrejta. Në këtë kohë zhvillohet hartografia ushtarake austriake e franceze, e cila me depërtime të drejtpërdrejta apo ilegale e vëzhgoi dhe incizoi terrenin e Turqisë evropiane dhe kështu lindën hartat e reja. Hartografimet e këtyre territoreve fillojnë me rastin e projektimit dhe ndërtimit të hekurudhës Selanik - Mitrovicë. Publikimi i këtyre hartave

bëhet në hartën e përgjithshme të Evropës Qendrore me shkallë të zvogëlimit 1 300.000. Hartografimi i territorit të Kosovës u realizua në bazë të skicave dhe matjeve gjeodetotopografike të udhëhequr nga Sterncku në vitin 1871, dhe elaboreteve të hekurudhës Selanik-Mitrovicë.

Kjo është harta e parë kur territori i Kosovës u paraqit me shkallë të mesme të zvogëlimit në baza shkencore. Harta u kompletua nga austriakët, të cilët e vazhduan këtë punë deri në fund të Luftës I Botërore. Më vonë u botuan harta nga shumica e shteteve evropiane, po ashtu edhe shteti shqiptar, institutet përkatëse, si dhe nga individët që merren me këtë lëmi.

Hartat më të përhapura janë të kohës më të re: Shipnija e vërtetë nga Lidhja e Prizrenit, Shqipëria etnike, pastaj harta fizike, etnografike, gjeologjike, hidrogafike, regjionale, turistike, vendbanimeve, si dhe një mori hartash shkollore, si në Shqipëri po ashtu edhe në Kosovë.

Koleksioni i hartave përmban rreth 1500 harta fletë, 50 harta të murit, 30 atlase, si dhe numër të konsiderueshëm të planeve të qyteteve dhe materiale të tjera.

Në kuadër të koleksionit të hartave hyn edhe atlaset, planet, globet, doracakët dhe referencat interesante nga hartografia dhe koleksionet e veçanta.

LITERATURA:

1. Cerabregu, Muharrem: Kosova në hartat e vjetra. - Prishtinë, 1977
2. Čanković, Dušana: Organizacija i uređenje zbirke geografskih karata u knjiznicama.- Zagreb, 1977
3. <http://www.DavidRumseyMapCollection>
4. <http://www.nsk.hr/zbirke/kartografika.html>
5. Stradonit, Mayer, Coroneli, Roselli, Mercator

BIBLIOTEKA - KOLEKSIONET MUZIKORE DHE PËRDORUESIT

EDONA MUNISHI-KOKOLLARI,

MUZIKOLOGE

BIBLIOTEKA MUZIKORE

Nga njohuritë e marra mësojmë se nuk ka fakultet ose akademi të muzikës të mjediseve të ndryshme kulturore që nuk ka bibliotekën e vetë. Po ashtu Biblioteka të muzikës ka edhe nëpër shkollat e mesme profesionale të muzikës.

Nga informacionet mësojmë se deri para luftës së fundit në Kosovë (1999) secila shkollë e muzikës ka pasur një bibliotekë, qoftë edhe modeste, të pajisur me literaturë profesionale muzikore (kryesisht në gjuhën serbe), një sasi të vogël veprash muzikore në partitura (literaturë shkollore) dhe një numër të vogël disqe me muzikës serioze. Po ashtu, në Fakultetin e Arteve ka funksionuar biblioteka e veçantë me literaturë nga artet në përgjithësi edhe nga muzika. Aktualisht asnjëra nga këto biblioteka nuk funksionon në asnjërin nivel arsimimi muzikor. Është e vërtetë se në Art Qendër ka një fond literature nga artet ku përfshihet edhe muzika, por në të mund të gjendet ndonjë enciklopedi, fjalor muzikor, libër mbi muzikën, pra një fond fare modest, i cili nuk shfrytëzohet pothuaj se fare nga përdoruesit e bibliotekave. Pra, në Kosovë tash për tash ekziston vetëm Sektori i muzikës në kuadër të Koleksioneve të Veçanta në Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës.

Në shumë qytete - qendra evropiane e botërore, ekzistojnë biblioteka të specializuara të muzikës që janë në shërbim të të interesuarve për lëmë krijuese artistike e shkencore. Si të tilla, bibliotekat e muzikës janë të specializuara. Ato

zakonisht janë të orientuara t'u shërbejnë përdoruesve kreativ e të arsimuar në lëmi të veçanta të muzikës. Pra, nevoja për biblioteka të muzikës ka lindur pikërisht nga kërkesat e këtyre përdoruesve që i shfrytëzojnë këto biblioteka si vend për studime e hulumtime, por edhe si vend për krijimtari artistike e muzikore. Së këndejmi, edhe niveli i shërbimeve të këtyre bibliotekave të specializuara është ngritur në atë shkallë sa t'i përshtatet këtij rrethi shoqërorë sa më shumë që të mundet. E një gjë e tillë po ndodh edhe me Sektorin e muzikës në BKUK, ndonëse me shumë sfida e vështirësi.

Vlen të theksohet se njohësve të teknikës dhe muzikëdashësve u është e njohur rruga e zhvillimit të mjeteve të fiksimit-incizimit dhe të pranimit të tingullit-muzikës gjatë kohës. Dhe, që nga paraqitja e gramafonit, më pas magnetofonit, radios e televizionit, droja se muzika si art po humb përjetimin e gjallë, dhe se po bëhet material i teknikës nuk ka pushuar. Mirëpo, koha gjithnjë ka demantuar skeptikët se të mirat që ka sjellë ky proces janë tepër të qarta dhe evidente në tërë zhvillimin e muzikës në përgjithësi nga fillimi shek. XX e këtej. E ky konstatim shpresojmë se do të mbetet i tillë edhe në këtë kohë të internetit, i cili ka integruar veçoritë e radios e të televizionit, dhe i cili ka paraqitur mjaft kërcënim për shumë krijues të muzikës, sidomos në fushën e shkeljes së të drejtës autoriale. Megjithatë, në vend të vështrimit të këtij mediumi me sy të dyshimtë, ai duhet të shfrytëzohet si mjet i fuqishëm i ofrimit të shërbimeve më të mira, të ofrimit të informacionit më të shpejtë, dhe në forma të ndryshme. Një arritje shumë e madhe e

mjeteve incizuese e reproduktuese të muzikës ka bërë ndikim të dukshëm edhe në mënyrën e pranimit dhe të përjetimit të muzikës si art ose si veprimtari argëtuese. Digjitalizimi, në këtë aspekt, ka zënë një vend të dukshëm në veprimtarinë e këtyre bibliotekave. Prania e internetit si mundësi e lehtë dhe e shpejt e ofrimit të informacionit ka bërë të mundur, në një anë, që i interesuari të njihet me informacionet muzikore në bibliotekat më të njohura botërore, e nga ana tjetër, të shfrytëzojnë informacionin e digjitalizuar e të "lindur digjital" nga çdo cep i botës.

KOLEKSIONET MUZIKORE

Materiali muzikor i koleksionuar dhe i vendosur në Bibliotekë do të grupohej në dy grupe të mëdha siç është: *Lënda muzikore konvencionale* dhe, *Lënda muzikore jokonvencionale*. Brenda këtyre grupeve degëzohen fondet e tjera sipas karakterit dhe natyrës së tyre. Për *konvencionale* merren botimet e karakterit në letër: librat, revistat për muzikën, pastaj muzikalet (notat-partiturat), programet e koncerteve, pllakatet, fotografitë, etj. Në *lëndë jokonvencionale* konsiderohen të gjitha materialet e incizuara në audio ose video teknikë, përfshirë edhe burimet e natyrës elektronike. Të gjitha këto i japin karakterin e bibliotekës së muzikës ose sektorit të muzikës së ndonjë biblioteke. Sigurimi dhe pasurimi me fonde muzikore nuk ka të kufizuar hapësirat kulturore, gjuhët dhe popujt. Mund të shtrohet pyetja se çfarë ka në Kosovë; çfarë materiale muzikore mund të gjenin vend në Bibliotekën Kombëtare dhe Unive-

rsitare të Kosovës (po edhe në biblioteka të tjera).

Kjo hapësirë kulturore ka një trashëgimi të pasur etnomuzikore të shtresuar nga koha në kohë, e cila paraqet vlera të veçanta të kulturës muzikore. Një pjesë e konsiderueshme e krijimtarisë së kompozitorëve të Kosovës është botuar dhe gjendet në partitura të shtypura, një pjesë është në dorëshkrime ende, por në çfarëdo forme qoftë ajo akoma nuk gjendet në tërësi në raftet e BKUK-së. Një pjesë e mirë e kësaj krijimtarie deri me tash është ekzekutuar - interpretuar në koncerte, festivale dhe shfaqje të tjera muzikore. Për këto realizime janë krijuar partiturat, janë shtypur programe, pllakate, fotografi, etj. Me kritere bibliotekare, më saktësisht muzikalet si lëndë konvencionale, do të ishte e domosdoshme që të gjitha këto ta kenë vendin në hapësirat e Bibliotekës, kur kemi parasysh se kjo Bibliotekë është me ligj edhe institucion i kopjes së detyrueshme. Ata pak studiues etnomuzikologë, muzikologë që kanë botuar vepra studimore karakteresh të ndryshme dhe ato pjesërisht mund të gjenden në Bibliotekë. Pra, pjesa e lëndës konvencionale muzikore që i takon karakterit të botimeve në letër mund të konstatohet se është fare pak e pranishme në BKUK-së. Deri në vitet e nëntëdhjeta të shekullit të kaluar në Kosovë ishte vetëm produksioni muzikor i RTK-së ku incizohej muzikë zhanresh të ndryshme, kryesisht në audio-kaseta. Asnjëri nga prodhuesit e muzikës nuk i kanë ofruar Bibliotekës materialet e tyre edhe pse shumë prej tyre janë informuar për interesat që ka ky institucion në grumbullimin e materialeve muzikore, si dhe duke ditur faktin se të gjithë botuesit e Kosovës e kanë për obligim t'i dërgojnë BKUK-së nga pesë njësi të secilit botim të tyre. Ky obligim është i përcaktuar me anë të Ligjit për Biblioteka, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës.

Mund të themi se lënda muzikore

jokonvencionale (disqe, audiokaseta, CD, DVD, e incizime e burime të tjera), që ka vlerë të pranueshme gati se nuk është fare e pranishme në Bibliotekë. Të njëjtat dilema mund të shtrohen edhe sa i përket veprimtarisë muzikore të zhvilluar në Shqipëri. Fare pak nga ajo që krijohet në këto treva, në rrafshin muzikor, gjen udhën për në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, gjë që paraqet një ngecje të madhe në zhvillimin e koleksioneve. Për krijimtarinë muzikore të krijuar në Shqipëri ndonëse nuk paraqitet ndonjë pengesë ligjore, shkaqet janë më shumë të natyrës financiare.

NJË KTHESË E FAVORSHME PËR SEKTORIN E MUZIKËS

Duke kërkuar burime financiare alternative, pikërisht për zhvillimin e Sektorit të muzikës, BKUK këtë vit ka pranuar një donacion prej 17,150 eurosh sipas një projekti nga Raiffeisen Bank. Realizimi i këtij projekti ka rezultuar në ndryshimin e tërësishëm të hapësirës së brendshme të këtij sektori. Tani përdoruesit e muzikës kanë hapësirë të rehatshme, mjete që u mundësojnë shfrytëzimin e materialeve të formave të ndryshme, si dhe ambient të përshtatshëm për zhvillimin e krijimtarisë së tyre shkencore, gjë që kishte munguar më parë.

Si çdo projekt, edhe ky udhëhiqej prej objektivave të vëna më parë. Prej tyre veçojmë ato më parësoret për zhvillimin e Sektorit të Muzikës:

Krijimi i parakushteve për shfrytëzimin e koleksioneve muzikore për përdorues në Bibliotekë;

Krijimi i një ambient të përshtatshëm i pajisur me mjete teknike të domosdoshme që mundëson shfrytëzimin e materialeve muzikore audio-vizuale;

Pasurimi i koleksionit muzikor me tituj partiturash e librash të fushës së muzikës me krijuesit më të njohur

shqiptarë dhe botërorë.

Nga këto tri objektiva shihet qartë se projekti po shkonte në tri kahje të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, në atë të një hapësire a) të rehatshme, b) të pajisur me teknologji dhe c) të pajisur me koleksione. Secili nga ky aspekt, hapësira, pajisjet dhe koleksionet kishin një qëllim - t'i ofrojnë përdoruesit informacion. Pra, projekti kishte një orientim ku përdoruesi ishte vënë në qendër të vëmendjes. Kjo paraqet një rëndësi me vete, pasi biblioteka nuk po realizonte një dëshirë të veten, por një dëshirë, nevojë dhe detyrim ndaj përdoruesit të specializuar të muzikës në Kosovë e më gjerë.

Gjithnjë duke mbetur në frymën e këtij projekti, zhvillimit të koleksioneve u është dhënë një prioritet i veçantë, duke pasur parasysh problematikën e shtjelluar më lartë sa i përket gjendjes së koleksioneve muzikore në BKUK. Së këndejmi, koleksionet janë paraparë të zhvillohet në dy drejtime në këtë projekt - në pasurimin e koleksioneve me materiale referale të muzikës, dhe me literaturë të kompozitorëve më të njohur shqiptarë dhe botërorë. Natyrisht, këto dy drejtime do të elaborohen deri në atë masë sa të lejojnë mjetet financiare në dispozicion. Së këndejmi, tani në faqen e internetit të BKUK-së (www.biblioteka-ks.org), përdoruesve të muzikës u ofrohen dy burime të specializuara e të pasura elektronike muzikore, Grove Music, Encyclopedia of Popular Music, në të cilat abonimi vlen deri në vitin 2010 falë këtij donacioni nga Raiffeisen Bank.

Në fund, mund vlerësojmë se arritjet dhe përpjekjet për avancimin e hapësirës dhe të shërbimeve në Sektorin e muzikës në BKUK po hapin një etapë të re të zhvillimit e të konsolidimit të mirëfilltë, profesionalizimit dhe bashkëpunimit profesional.

RËNDËSIA E MBROJTJES SË MATERIALIT BIBLIOTEKAR

BLERTA SLISHANI

Konservimi është lëmi e gjerë, prandaj për të gjithmonë ka çka të flitet. Vetë proceset nëpër të cilat kalon materiali për të ardhur në gjendje të përdorshme janë të gjata. Në restaurim nuk vlerësohet puna sipas afatit kohor, por e rëndësishme është puna cilësore pa marr parasysh se sa zgjat ajo. Një shprehje e vjetër e Besariatit për librat thotë: “i njëjti varr do të merrte me vete bashke me trupat e njerëzve edhe kujtesën e njerëzve, po të mos ishte libri dhe veprat e artit”. E që këtyre veprave t’u shtohet jetëgjatësia nuk mjafton vetëm identifikimi i tyre, por nevojitet intervenimi me kohë, në mënyrë që e kaluara të jetë me ne.

Ruajtja është punë që e parandalon, ngadalëson, ose e ndal dëmtimin e materialit bibliotekar ose arkivor. Konservimi është mirëmbajtja e çdo materiali bibliotekar ose arkivor në gjendje të përdorshme. Restaurimi dhe konservimi është metoda më e mirë e ruajtjes së veprës përkatësisht historisë apo të kaluarës. Momenti estetik është dora e mjeshtrit që e punon në mënyrë artistike duke e kthyer kohën, të kaluarën, historinë, si dhe kujtesën tonë.

Materialet që restaurohen kanë vlerë për të sotmen dhe të ardhmen, sepse aty gjendet një pjesë e trashëgimisë sonë intelektuale e kulturore. Kur flasim për koleksionet e veçanta, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e tyre e kemi fjalën pikërisht të libri i rrallë dhe i vjetër dhe dorëshkrimit.

E kaluara jonë ka qenë e vështirë me mundësi të pakta për përkujdesje për librat e vjetër, dorëshkrimet, fotografitë dhe monumentet e tjera me vlera kulturore të traditës sonë kombëtare.

Prandaj ne sot mund të krenohemi se kemi arritur të krijojmë dhe ta bëjmë funksionale Qendrën e Restaurimit dhe Konservimit, e cila detyrë themelore ka ruajtjen dhe kujdesin ndaj koleksioneve të përgjithshme e në veçanti ndaj koleksioneve të veçanta në pronësi të Bibliotekës dhe jashtë saj.

Kjo qendër edhe pse e krijuar qysh herët praktikisht ka filluar së funksionari para 4 viteve me trajnimet e stafit të saj që fillimisht u bënë në Arkivin e Kosovës dhe më pastaj në Tiranë, SHBA dhe Paris.

Vitin e kaluar Qendra e Restaurimit dhe Konservimit është pajisur me aparaturë të re e që është një punë shumë e mirë që është bërë për herë të parë, pas luftës, në BKUK për këtë laborator restaurimi.

Të gjitha materialet bibliotekare u ekspozohen dëmtimeve nga lagështia, drita, pluhuri, insektet, brejtësit dhe dëmtuesit e tjerë, sidomos në vendet ku këto materiale ruhen (depo). Në rrethanat dhe kushtet tona, mbrojtja por edhe restaurimi i materialeve është i kushtëzuar nga furnizimi në vazhdimësi me material shpenzues dhe teknik që çdo herë i përshtatet rrethanave të punës dhe modernizimit të laboratorit.

Procesi i vjetërimit të letrës është problem mjaft i rëndësishëm për të gjithë ruajtësit e dokumenteve. Meqenëse të gjitha materialet organike janë vazhdimisht të rrezikuara që të dëmtohen dhe të shkatërrohen, kuptohet se është vështirë që koleksionet bibliotekare si pjesë e trashëgimisë së një vendi të ruhen të padëmtuara. Procesi i “vjetërimit natyror”, mund të bëhet më i shpejtuar ose më i ngadalë në varësi të kushteve të ruajtjes.

Vjetrimi i letrës ndodh edhe në

kushte të mira të ruajtjes, por shumë më ngadalë. Shkaku kryesor i shkatërrimit natyror të materialeve bibliotekare është kualiteti i letrës e kur kësaj i shtohet fakti se, sot çdo ditë e më tepër po shfrytëzohen prodhime jo kualitative të letrës atëherë kjo e bën punën e ruajtjes edhe më të paparashikueshme.

Kështu letra e vjetër e prodhuar me dorë në pjesën më të madhe është ruajtur deri në kohët tona në gjendje të mirë. Me kalimin e viteve nxitja e prodhimit masiv ka qar në uljen e cilësisë së materialeve përfshirë edhe atyre bibliotekare. Mirëpo, me kalimin e kohës letra pëson një vjetrim natyral të pashmangshëm duke ndryshuar disa veti kimike e fizike të saj.

Letra e përgatitur nga pambuku, liri, këрпи, etj., ose nga tekstilet që përbëhen prej tyre, dallohet me cilësinë, fortësinë, rezistencën ndaj veprimit të dritës, lagështisë natyrore të mjedisit, etj. Kjo i dedikohet përmbajtjes së lartë të celulozës deri 90%. Kështu letra e vjetër e prodhuar me dorë në pjesën më të madhe është ruajtur deri në kohët tona në gjendje të mirë. Njëkohësisht letra e gjysmës së dytë të shek të XIX-të dhe shumë lloje të letrës moderne nuk kanë jetëgjatësi. Ky fenomen shpjegohet me përbërjen kimike të letrës ashtu dhe me procesin teknologjik të përgatitjes së saj. Deri nga gjysma e parë e shek. të XIX-të letra përgatitej më tepër nga fibra tekstili, të pambukut dhe lirit. Përmbajtja e celulozës së pastër në të arrin deri në 95%.

Me kalimin e viteve nxitja e prodhimit masiv ka çuar në uljen e cilësisë së materialeve përfshirë edhe atyre bibliotekare. Duke filluar nga pjesa e dytë e shekullit të XIX-të për përgatitjen e letrës, filloi të përdorej

druri. Përpunimi kimik të cilit i nënshtrohet celuloza e drurit gjatë procesit të prodhimit, e ul fortësinë natyrale të fibrave celulozike, prandaj edhe letra e përgatitur nga fibrat celulozike drunore në krahasim me letrat e vjetra është më pak e qëndrueshme dhe më e dobët (më pak kualitative).

Është konstatuar se në gjendje shumë të rëndë në BKUK janë dorëshkrimet orientale dhe librat e vjetër të lidhur me lëkurë e për restaurimin e tyre duhet trajtim me materiale më delikate që nuk e dëmtojnë ngjyrën, duke pasur parasysh se ato janë të shkruara me dorë dhe me rëndësi të posaçme në restaurim është mbrojtja e shkrimit, e që është rregull për restaurim d.m.th: ruajtja e origjinalitetit (përshtatja sa më e madhe me origjinalin), si dhe për rregullimin e kopertinave nga lëkura duhen një numër i madh i pajisjeve si dhe trajnim i stafit jashtë vendit. Po ashtu në gjendje jo të mire janë edhe hartat dhe muzikalet të cilat gjithashtu bëjnë pjesë në Departamentin e Koleksioneve të Veçanta.

Shërbimi i konservimit të librit dhe letrës është përgjegjës për stabilizimin kimik dhe tretmanin fizik dhe në tërësi për të gjitha materialet e rralla dhe të vjetra. Këtu përfshihen: restaurimi dhe konservimi i hartave, atlaseve, dorëshkrimeve, globeve, gjërave të shtypura dhe vizatimeve, fotografive, dhe materiale të tjera të lidhura.

Stafi i kësaj qendre duhet në vazhdimësi të kërkojë konsultime këshilla nga specialistë të këtij lëmi për mbikëqyrjen e shërbimit të restaurimit në bibliotekë dhe të kujdeset në ndarjen e punëve të veçanta në shërbimin e konservimit dhe libërlidhjes. Gjithashtu këshillat dhe konsultat e specialistëve nevojiten në fazën e seleksionimit të materialit për restaurim si dhe për tretmanin që do t'i bëhet më tutje këtij materiali.

Materiali i dëmtuar kalon nëpër disa procese pa marrë parasysh se a është libër, gazetë dorëshkrim, etj. Këto

procese janë:

- Pastrimi mekanik, heqja e pluhurit në të thatë;
- Dezinfektimi (intervenimi i parë kur duhet të kryhen);
- Dezinfektimi;
- Ndarja e fletëve (nëse janë të ngjitura);
- Neutralizimi;
- Tharja e fletëve dhe rrafshimi i tyre duke i vendosur në presë;
- Restaurimi me dorë;
- Qepja.

Nëse materiali që restaurohet është libër, atëherë qepja duhet të bëhet me penj të cilët po ashtu kanë ngjyrë dhe trashësi të ndryshme, restaurimi i kopertinave, shpinës, qosheve, dhe në fund, pas përfundimit të restaurimit, të gjitha materialet duhet të ruhen në kutia me kopertina nga kartoni me pH neutrale, duke pasur kujdes që të mos shtrëngohen shumë, sepse mund të dëmtohen.

Ruajtja e dokumenteve varet nga disa kushte, si:

- Kushtet e ambientit rrethues;
- Cilësia e lëndëve të para prodhuese;
- Fatkeqësitë natyrore;
- Përdorimi gjatë shfrytëzimit (përdoruesit).

Me rëndësi të posaçme është edhe vendosja e librave në raftet, e cila bëhet në disa mënyra: në bazë të lëndës, në bazë të formatit të librit, në bazë të gjuhës, etj. Nëse vendosen librat në bazë të formatit, atëherë ruajtja dhe pastrimi bëhet më mirë, sepse marrja dhe kthimi në raftin e vet është më lehtë dhe më i sigurt.

Për ruajtjen dhe jetëgjatësinë e materialit bibliotekar siç janë: dorëshkrime, filmat, mikrofilm, fotografite etj., është e rëndësishme të sigurohen kushtet optimale si dhe vendosja në kutia special për këto materiale.

Me kalimin e kohës në laboratorin e konservimit u futën shumë metoda të reja duke u ikur, aq sa është e mundshme, metodave klasike. Por, varësisht se çfarë materiali është në pyetje të punohet edhe metodat ndryshojnë (të reja apo të vjetra), mirëpo pa marrë parasysh çfarë metodash përdorim,

duhet të kemi kujdes në këto çështje:

- Nuk bën të kryhet asnjë proces i cili e dëmton ose e dobëson materialin që e përpunojmë, si dhe nuk bën të ndërrohen proceset e parapara;
- Në kohën e rregullimit të dorëshkrimit apo dokumentit nuk guxojmë që të mënjanojmë asgjë, të dëmtojmë ose të fshehim diçka me interes në dokument, dorëshkrim apo libër që d.m.th. asnjë shkronjë, asnjë pjesë me vlerë apo numër, datë, etj, nuk guxon të mënjanohet (dëmtohet);
- Është më së miri që restaurimin e letrës ta bëjmë me letër, të pergamenit me pergamenë, e të lëkurës me lëkurë;
- Para se të fillohet me konservim duhet që çdo objekt (libër, dorëshkrim, gazetë, revistë, hartë, etj.), ta fotografojmë;
- Librin (materialin) e fotografojmë fletë për fletë. Të gjitha fletët e librit apo dorëshkrimit, nëse nuk janë të numëruara, duhet të numërohen dhe secila pas restaurimit të vendoset në vendin e vet;
- Në inventarin e konservimit duhet të shënohet gjendja e materialit para dhe pas konservimit, si dhe intervenimet që janë bërë (kryer) në atë material;
- Pas përfundimit të punës duhet të shënohet mënyra e punës, mjetet të cilat janë përdorur, ashtu që të lehtësohet puna e konservatorit tjetër kur të nevojitet të intervenohet në atë libër ose material herën tjetër.

Prej materialeve të cilat janë restauruar në Qendrën e Restaurimit dhe Konservimit, nga fillimi e deri më tash - pra që katër vite, prej kura ka filluar punën kjo Qendër, janë gjithsej 117, prej tyre libra të rrallë dhe të vjetër - 31, revista - 18, gazeta - 38, dorëshkrime - 28, pamflete - 2, kalendar - 1, telegram - 1.

Do të duhej përkrahje e vazhdueshme nga të gjitha institucionet tona duke pasur parasysh vlerën tejet të madhe që ka ky shërbim në ruajtjen e materialeve me vlerë kombëtare e të cilat në vazhdimësi janë të rrezikuara.

SFIDAT DHE ROLI I BIBLIOTEKËS PËRBALLË PUBLIKUT

LUTFIE HOTI

Profesioni bibliotekar, sikurse edhe çdo profesion tjetër, duhet të komunikojë me publikun ngase vetëm kështu mund ta bindë atë se punët dhe detyrat e veta i kryen në mënyrën më të mirë në pajtim me obligimet profesionale. Kur dëshirohet mendimi profesional mbi ndonjë çështje profesionale për të cilën është interesuar publiku, atëherë për një mendim të tillë shpeshherë pyeten ekspertë profesionalë, si dhe përfaqësues të asociacioneve profesionale nga fusha e bibliotekarisë.

Në këtë drejtim një rol të veçantë luajnë, përveç bibliotekës, edhe asociacione të rëndësishme që janë pjesë e preokupimeve bibliotekare, të cilat mund të krijojnë një pasqyrë të rëndësishme për bibliotekat dhe bibliotekarët, rolin e profesionit të bibliotekarit në publik, i cili me shembullin e vet është i përgjegjshëm karshi nevojave të publikut për informim.

Për rolin, detyrat dhe qëllimet e veprimtarisë bibliotekare duhet flitet qartë, haptas dhe thjesht. Për këto qëllime dhe këto detyra është shkruar shumë në literaturën për bibliotekarinë dhe bibliotekat dhe të gjithë pajtohen se roli dhe misioni i bibliotekave do të duhej të zhvillohej në përputhje me nevojat e publikut, që nënkupton përcjelljen e ndryshimeve sociale dhe teknologjike të shoqërive moderne, të cilat, gjithashtu, mundësojnë nxënien e njohurive më të mira, pra të ngritjes profesionale të stafit bibliotekar.

Kjo është e lidhur edhe me sensibilitetin e shoqërive demokratike, për nevojën dhe të drejtën e individit për informim, rëndësinë dhe rolin e bibliotekës në shoqëri, mbi përmirësimin e shërbimeve, nxitjen e lirisë intelektuale, përcaktimin e bashkëpunimit ndërbibliotekar, zbatimin e teknologjisë informative në biblioteka etj..

Biblioteka rol të rëndësishëm ka në bartjen e mendimeve dhe qëndrimeve profesionale mbi disa çështje që i interesojnë publikut, i cili përdor shërbimet bibliotekare. Duke u nisur nga kjo, parashtrohet pyetja se cili është roli i bibliotekës në mes dijes dhe publikut, çka duhet bërë dhe cilat institucione duhet të angazhohen që biblioteka të jetë një institucion kulturor e arsimor me epitelin Lider për fitimin e dijes dhe të lidhjes direkt në mes dijes dhe publikut në shoqëritë demokratike.

Bibliotekat ndërtojnë imazhin e vet duke zhvilluar dhe promovuar veprimtarinë e vet, duke përhapur në publik ide dhe informacione sa më të freskëta mbi punën e vet dhe duke prezantuar njohuri të reja.

Piter Brofi në librin "Biblioteka në shekulli 21", thotë se thelbi i bibliotekës është që të jetë në qendër të vëmendjes në mes informacionit dhe përdorimit, në mes atij që jep informacionin dhe atij që e shfrytëzon atë informacion, dhe se bibliotekë e suksesshme mund të jetë ajo bibliotekë e cila udhëheqë me shërbimet e veta, ashtu që maksimalisht ta rrisë fitimin e dijes. Në këtë kontekst, të

ndihmuara nga zhvillimi i lartë teknologjik, me grumbullimin e informatave, me krijimin e degëve të ndryshme shkencore, bibliotekat do të duhej të ndërmarrin një detyrë përgjegjëse të liderit për të gjitha këto kërkesa, për proceset edukative dhe arsimore, të komunikimit, krijimit të lidhjeve kulturore dhe multidisiplinare. E gjithë kjo pritet nga një bibliotekë, por a janë këto në gjendje të përballen me këto sfida. Në një vend në konsolidim si Kosova, pozicioni i bibliotekës dhe bibliotekarit do të duhej përmirësohej nëpërmjet një angazhimi të të gjithë strukturave qeveritare e intelektuale (akademike), meqë cilësia në arsim është e kushtëzuar edhe nga niveli i zhvillimit dhe pasurimit të bibliotekave me koleksione dhe hapësira të përshtatshme për punë - sa ato arrijnë t'u përgjigjen kërkesave të publikut, në veçanti nxënësve, studentëve dhe stafit mësimdhës në nivele të ndryshme shkollimi. Një rol të veçantë, përveç institucioneve përgjegjëse shtetërore, mund të luajë edhe shoqëria civile - organizatat joqeveritare, të cilat do të mund të sensibilizonin dhe të ndihmonin nëpërmjet projekteve të bashkëpunimit me bibliotekat e të gjitha tipave, meqë dihet se bibliotekë funksionale dhe e suksesshme mund të jetë ajo bibliotekë e cila është pike fillestare e marrjes së informacioneve dhe fitimit të dijes. Pra, duke besuar se biblioteka është një vend i cili mbledh dhe distribuon të gjitha informatat te të gjithë njerëzit pa dallim gjinie,



moshe race apo kombësie, duhet t'u ndihmohet bibliotekave që ato t'u përgjigjen nevojave dhe kërkesave të gjithë popullsisë dhe të gjitha kategorive.

Bibliotekaria si lëmi ka hyrë në trendin e ndryshimeve të mëdha, e kushtëzuar para se gjithash me rritjen e zbatueshmërisë së teknikës kompjuterike, me rritjen e prodhimit të librave dhe informacionit si dhe të lloj-llojshmërisë së kërkesave të përdoruesve në një demokratizim të shpejtë të shoqërisë. Në këtë kontekst, çdo ditë e më shumë puna jonë (pra e bibliotekarit) dhe marrëdhënia ndaj përdoruesit i ekspozohen syrit të publikut.

Të jesh një bibliotekar i mire, e shpresoj se ky edhe është qëllimi ynë, nuk është gjithmonë lehtë,

sepse bibliotekari në njërin anë duhet të jetë i njoftuar me të gjitha ndryshimet dhe risitë të cilat kanë të bëjnë me informacionet dhe përpunimin e informatave, por nga ana tjetër duhet edhe të ketë shkathtësi për punë me përdoruesit d.m.th. duhet të jetë “mjeshtër” për informata dhe komunikim me publikun. Tashmë kemi të bëjmë me bibliotekat elektronike (katalogimi elektronik, librat dhe periodiku elektronik, botimet multimediale), dhe evoluimi i shpejtë i teknologjive informative, kërkon angazhim dhe dije për t'i përballuar me sukses bibliotekari kërkesat e përdoruesve - morinë e pyetjeve dhe dilemave në kërkim, meqë biblioteka sot nuk janë vetëm depo të thjeshta të librave, por

institucione që ofrojnë një mori formash të informacionit e të koleksioneve. Pra, për veprimtarinë profesionale të bibliotekarëve është mëse e nevojshme një shkathtësi në ofrimin e informacioneve, aftësi të bashkëpunimit - të dialogut me përdoruesin dhe, në këtë rast, bibliotekari është në një rrethanë të re për të perceptuar vëmendshëm afinitetet dhe rolin e tij, për t'u gjetur në ndihmë përdoruesit dhe kërkesave të tij shumë specifike. Prandaj, nga bibliotekari referal - formati i tij i dijeve dhe kërkimeve, sot kërkohet një kulturë e veçantë për të ditur si të tkurrë ose si të zgjerojë kërkimin në burime elektronike - në atë që është kërkesë e përdoruesit për shërbim të shpejtë e të saktë.

KULTURA, BIBLIOTEKA, MEDIA

BERAT DAKAJ

Kultura ka zanafillën në kohën e krijimit të njeriut, por prejardhja e fjalës kulturë, si fjalë dhe si nocion, është me origjinë romake. Kultura ka lindur nga kultu, burimet e saj janë sakrale. Ajo lindi në afërsi të altarëve dhe sipas natyrës së saj organike ishte e ndërlidhur me jetën religjioze. Kështu ishte edhe në kulturat e mëdha antike, në kulturën greke, kulturën mesjetare dhe kulturën e Rilindjes së hershme.

Fjala “kulturë” rrjedh prej fjalës “colere”, që do të thotë të kultivosh, të banosh, të përkujdesesh, të ruash. Teoricieni Ali Bullaç thekson se elementi më i rëndësishëm i kulturës është gjuha – sistemi i simboleve i cili shërben për informimin dhe kuptimin ndërnjerëzor. “Pa gjuhën nuk mund të zhvillohet asnjë institucion dhe vlerë shoqërore”, shkruan ai. Pra, nga ky kontekst mund të shkoqisim edhe një përkufizim tjetër logjik për nocionin (më shumë se fjalë) kulturë, e cila, domosdo që nënkupton dhe ngre pas vetes njerëz, veshje, tradita, objekte e fenomene të ndryshme, të zakonshme e të pazakonshme nga e tërë bota.

Mirëpo, kjo kulturë mbarëbotërore, e këtillë çfarë shtrihet në të gjithë natyrën e njerëzit, në gjërat e bukura e të mira, mund “të kërcënohet kur të gjitha objektet dhe sendet e kësaj bote, të prodhuara prej së tashmes ose të kaluarës, trajtohen si funksione të thjeshta të procesit jetësor të shoqërisë, sikur ato të ekzistonin vetëm për t’i përmbushur disa nevoja, dhe për këtë funksionalizim është thuar pa vend të thuhet nëse nevojat në fjalë janë të një niveli të lartë ose të ulët”, konstaton sociologu Hannah Arendt në librin eseistik “Ndërmjet të shkuarës dhe të ardhmes”. Atëherë çfarë u dashka bërë? Forma më e mirë për aktivitetet

kulturore dhe për çdo aktivitet të akëcilit institucion është komunikimi i tyre me publikun nëpërmjet mediave.

POR, ÇDO TË THOTË KULTURË?

Disa përkufizime të ndryshme për nocionin kulturë janë dhënë në kohë të ndryshme, por ruajtja e thelbit të saj mbetet përherë e njëjtë. Eugen Unesco në kulturë gjente veçoritë materiale dhe shpirtërore, intelektuale dhe emocionale, që e karakterizojnë shoqërinë ose ndonjë grup social.

Përveç artit dhe letërsisë, kultura përfshin edhe stilet jetësore, të drejtat themelore të njeriut, sistemin e vlerave, traditën dhe besimin... Pra, kultura është ajo që i ofron njeriut horizont shikimesh dhe përsiatjesh mbi vetveten. Është ajo që na bënë qenie njerëzore, të arsyeshme dhe të formuara moralisht.

Por, të lexojmë se çfarë shpjegimi jep fjalori enciklopedik shpjegues për nocionin: “Kulturë, - tërësia e arritjeve të një populli dhe të gjithë njerëz-it, në fushën e prodhimit dhe në zhvillimin shoqëror e mendor; shkalla e këtyre arritjeve dhe e këtij zhvillimi në një etapë të caktuar; fusha e zhvillimit shoqëror që përfshin krijimtartinë e gjithanshme në gjuhë, në art, në letërsi, në shkencë dhe në tërë jetën shpirtërore”.

E studiuesi Claude Levi-Strauss, në një ese të tijën “Bota si koalicion kulturash”, ka shkruar: “Qytetërimi botëror nuk mund të jetë ndryshe përveçse koalicion kulturash në përmasa botërore, të cilat ruajnë origjinalitetin e vet”. Kurse shkrimtari gjerman Herman Hese thotë se qëllimi i kulturës është “promovimi i aftësive dhe veprave të veçanta, por ajo na ndihmon t’i japim një kuptim jetësor, të kuptojmë të kaluarën dhe ta presim krahehapur të ardhmen”.

DIALOGU NDËRKULTUROR MEDIUMI, BIBLIOTEKA, PUBLIKU

Por nga ky kontekst kulturor është i pashmangshëm ai medial/politik. Publicisti i njohur shqiptar, Branko Mërxhani, vë në dukje se “çdo shoqëri shfaq dy vullnete sociale. E para është kultura, e dyta është politika”.

Në kulturën tonë, dhe përgjithësisht botërore, në masë ta madhe ka ndikuar kultura mediale (gazeta më pak, interneti, televizioni më shumë). Teoricienët e gazetarisë (studimeve të komunikimeve masive) sot çdoherë kontekstin kulturë, shoqëri e zhvendosin në lidhje mediale se, janë mediat ato që përcojnë te çdo publik mesazhin qoftë sociologjik, kulturor, letrar, politik etj. Pra, i tëri ky raport mund të jetë i ndërsjellë ose kunfliktuoz nëse “mediumi është ai që kontrollon dhe përcakton përmasat dhe formën e veprimeve e raporteve njerëzore”.

Mediat përcjellin informata për ngjarje të ndryshme, për mënyrën e sjelljes së çdo individi ose institucioni. Edhe Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës nëpërmjet revistës “Bibliotetra” përpiqet ta mbajë një komunikim më të afërt me publikun. Ajo nëpërmjet kësaj reviste, e cila botohet katër herë në vit, përgatit raportet e aktiviteteve dhe të ngjarjeve të bibliotekës. Gjithashtu, BKUK-ja nëpërmjet adresës elektronike www.biblioteka-ks.org jep informacione për të gjitha ato aktivitete që zhvillon. Po në këtë adresë jepen informacione shumë të zgjeruara për historikun e bibliotekës, për ligjet e bibliotekave, për stafin e bibliotekës, për departamentet e bibliotekës etj.

Por, Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës sot i mungon një katalog (qoftë i shtypur qoftë elektronik) për librat e rinj që blen dhe që i dhurohen, i cili do të ishte i rëndësishëm nëse do të shoqërohej me ndonjë recension të shkurtër për përmbajtjen e librit.

TIPOLOGJI DHE HISTORI E BIBLIOTEKAVE

(Mr. Tahir Foniqi: "Tipet e Bibliotekave në Kosovë: 1944-1986", BKUK, 2008)

ADIL OLLURI

SHEMSEDIN MORINA

Libri i Mr. Tahir Foniqit "Tipet e bibliotekave në Kosovë: 1944-1986", i botuar në vitin që lamë pas (2008), është një kontribut që ka rëndësinë e vet për zhvillimin e bibliotekarisë në vendin tonë. Një libër jo voluminoz (diku rreth 100 faqe), në të cilin me pak fjalë janë thënë shumë gjëra, ku pasqyrohen fazat e zhvillimit të bibliotekave në Kosovë.

Ky libër i Foniqit ndahet në pesë kapituj, të cilët trajtojnë probleme të ndryshme nga njëri-tjetri: 1. Tipat e bibliotekave në Kosovë; 2. Struktura e koleksioneve të bibliotekave; 3. Struktura e përdoruesve (lexuesve) të bibliotekave; 4. Kuadrot bibliotekare dhe rregullimi profesional i bibliotekave; 5. Veprimtaria arsimore e kulturore e bibliotekave. Por, kapitulli më i rëndësishëm, për mendimin tonë, është kapitulli i parë, i cili ka më shumë material se sa katër të tjerët, si dhe është më domethënësi.

Kur themi më domethënësi kemi parasysh faktin se në këtë kapitull kemi një tipologji dhe histori të formimit të bibliotekave te ne. Madje, mund të themi me plotë bindjen se ky është studimi i parë tipologjik mbi bibliotekat që bëhet nga ndonjë studiues shqiptar. Është histori sepse këtu jepet një kronologji e saktë e formimit të institucioneve të para bibliotekare në Kosovë. Lidhur me këtë, Foniqi saktëson se bibliotekat e para që janë hapur në Kosovë janë bibliotekat sindikale, të themeluara nga punëtorët e ndërmarrjeve të ndryshme, të cilët edhe ndihmonin në mënyrë materiale, duke siguruar libra për pasurimin e fondeve të këtyre bibliotekave. Po ashtu, mund të themi se kjo nismë solide e sindikalistëve është një hap që i paraprinë zhvillimit të këtij aktiviteti bibliotekar, duke u pasuar kështu me hapjen e bibliotekave publike

nëpër qytete e treva të ndryshme të vendit tonë, për t'u kurorëzuar me hapjen e Bibliotekës Popullore dhe Universitare të Kosovës (sot Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës). BPUK-ja, edhe pse ka dilema rreth vitit të themelimit, është hapur në qytetin e Prizrenit, për t'u zhvendosur pastaj në Prishtinë. Kjo bibliotekë u zhvillua në dy faza, ku në fazën e parë, nga viti 1945 deri në vitin 1952, është quajtur Biblioteka Krahinore, ndërsa në fazën e dytë, që është fazë e rithemelimit dhe fillon nga viti 1961, merr emrin Biblioteka Popullore Krahinore, ku pas hapjes së Universitetit të Prishtinës në vitet '70 ajo merr emrin Biblioteka Popullore dhe Universitare e Kosovës. Duhet pasur parasysh se Mr. Tahir Foniqi në këtë libër flet për zhvillimin e tipave të bibliotekave deri në vitin 1986, andaj në këtë libër nuk flitet për fazën kur asaj i ndërrohet emërtimi nga Biblioteka Popullore në Bibliotekë Kombëtare (BKUK).

Foniqi, përveç për këtë bibliotekë, flet edhe për tipe të tjera të bibliotekave, siç janë bibliotekat publike të qyteteve tona kryesore, pastaj flet për bibliotekat e fëmijëve, të cilat funksionojnë në kuadër të bibliotekave publike. Lidhur me këtë, ai e merr si shembull ilustrues bibliotekën "Përrallat", e cila është degë e Bibliotekës Ndërkomunale "Hivzi Sylejmani" të Prishtinës. Ai më pas flet edhe për tipa të tjerë, si bibliotekat lëvizëse, bibliotekat universitare, ku në këtë kuadër hyjnë bibliotekat e fakulteteve dhe bibliotekat e shkollave të larta pedagogjike. Pastaj, këtu flitet edhe për tipin e bibliotekave speciale, ku autori merr si shembull Bibliotekën e Muzeut, Bibliotekën e Institutit Albanologjik të Prishtinës, Bibliotekën e Fabrikës "Ramiz Sadiku" në Pejë.

Kapitulli vijues trajton tema të ndryshme që kanë të bëjnë me strukturën e koleksioneve bibliotekare, ku spikaten temat, si struktura e koleksioneve të librit, struktura e koleksioneve të

librit sipas gjuhëve, struktura e librit të bibliotekave publike sipas KUD-it, struktura e periodikut etj. Në kapitullin e tretë flitet për kuadrot e bibliotekave dhe rregullimin profesional të bibliotekave, ku vlen t'i përmendim disa njësi tematike mbi skedarët e Bibliotekës Popullore, si skedari publik alfabetik, skedari publik sistematik dhe skedari intern alfabetik i përdoruesit. Në të katërtin flitet veçanërisht për organizimin e brendshëm të BPUK-së, ku Foniqi na shpjegon për seksionet që kanë ekzistuar në të (sot shumica e këtyre seksioneve janë shndërruar në departamente në BKUK), siç janë seksioni i punëve të përbashkëta, seksioni për përpunimin e veprimtarisë bibliotekare, seksioni për pasurimin e fondeve, seksioni i bibliografisë, seksioni i periodikut etj. Ndërsa, në të pestin Foniqi na informon për veprimtaritë arsimore e kulturore të bibliotekave, siç janë ekspozitat e librit, veprimtaria botuese e bibliotekave, ligjëratat nga fusha e bibliotekarisë, mbremjet letrare, promovimet e librit etj.

Mr. Tahir Foniqi, punonjës shumëvjeçar i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare, ka botuar një sërë librash studimor në fushën e bibliotekarisë dhe bibliografisë, si: "Tema nga bibliotekaria", "Bibliografia e revistës Koha: 1978-1989", "Monografi për Bibliotekën Ndërkomunale të Prizrenit (bashkautor)" dhe "Kërkime bibliografike". Ai, po ashtu, njihet edhe si poet dhe prozator ku ka botuar një sërë vëllimesh me poezi, tregime dhe novela. Po ashtu, në korpusin e tij krijues një vend të rëndësishëm zë edhe monografia "Dueti legjendar", e cila i kushtohet rapsoëve tanë të shquar, Sali e Feriz Krasniqi.

Përfundimisht, mund të themi se libri "Tipet e bibliotekave në Kosovë: 1944-1986", është një nga librat e tij më të rëndësishëm, ngaqë në të trajtohen tema dhe probleme të shumanshme nga fusha e studimeve bibliotekare. Pra, Foniqi i ka dhënë kësaj fushe një studim historik dhe tipologjik, për të cilin ia vlen të flitet, të trajtohet, por edhe të mësohet nga ai për rrjedhën kronologjike të formimit të institucioneve bibliotekare dhe për dallimet që ekzistojnë ndërmjet këtyre institucioneve.

BIBLIOTEKA NDËRKOMUNALE E PRIZRENIT

(Historiku dhe perspektivat)

SAHADETE SADIKAJ

Qyteti i Prizrenit kishte fatin që të jetë vend ku janë themeluar shumë institucione të Kosovës, ndër to edhe biblioteka. Kur flasim për kohën e themelimit të bibliotekave, rëndom u referohemi shkrimeve të ndryshme, që japin dëshmi për ekzistimin e tyre qysh herët. Dëshmitë për ekzistimin e bibliotekave në Prizren japin vitin 1513, me bibliotekën e Suzi Çelebiut.

Ndërsa, në shekullin e 20-të, në kohën e zhvillimeve historike dhe politike, që lidhem kryesisht me fatin e shqiptarëve, më datën 25.12.1944 themelohet biblioteka e parë në Kosovën e pas Luftës së Dytë Botërore. Dy vjet më pas biblioteka kaloi në Prishtinë, e njohur me emrin Biblioteka Popullore (tash Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës).

SEKTORËT E BIBLIOTEKËS

Biblioteka Ndërkomunale e Prizrenit, në fillimet e para ka funksionuar si bibliotekë pa sektorë të veçantë, me koleksione të përbashkëta për të gjithë profilet e lexuesve. Në vitin 1956, është formuar Sektori i Fëmijëve, pastaj më vonë edhe sektorë të tjerë. Tash biblioteka aktivitetin e vet e zhvillon nëpërmjet funksionimit të këtyre sektorëve: Sektori i fëmijëve, Sektori i të rriturve, Sektori i përpunimit, Sektori i hulumtimit dhe zhvillimit, Sektori i leximit, Sektori i internetit, Sektori i periodikut, Fondi i vendlindjes, Këndi Amerikan (i formuar nga Ambasada Amerikane), Liberbusi / Infobusi (donacion i Fondacionit për

Shoqëri të Hapur), si bibliotekë lëvizëse, e cila frekuenton 21 fshatra të ndryshme, në mesin e tyre edhe fshatra, në të cilat nuk ka bibliotekat.

Në kuadër të Sektorit të përpunimit, ka filluar aplikimi i programit të automatizuar bibliotekar ALEPH 500, ku kanë filluar njësitë e para të përpunohen në Modulin e katalogimit. Funksionimi i këtij programi është mundësuar falë ndihmës së BKUK, ndërsa ekziston projekti për zgjerimin e këtij programi brenda vetë Bibliotekës Ndërkomunale të Prizrenit si dhe në biblioteka komunale e shkollore.

FONDI I BIBLIOTEKËS

Pasurimi i fondeve të bibliotekës kishte faza të caktuara zhvillimi, por edhe telashe. Fillimisht, zhvillimi i fondeve të Bibliotekës Ndërkomunale të Prizrenit u nis me një numër të vogël librash, po pastaj pati rënie dhe ngritje, të cilat u kushtëzuan nga zhvillimet politike në Kosovë. Në shumicën e fazave të zhvillimit të kësaj biblioteke, fondet u pasuruan në përputhje me kërkesat e për-


doruesve dhe të nevojave arsimore të vendit.

Nga të dhënat e përgjithshme për fondin e librave - numrin e ekzemplarëve, sipas gjuhëve, të nxjerra në fund vitit 2007, del se në gjuhën shqipe janë - 45101 ekzemplarë, në gjuhën serbe - 25442, në gjuhën boshnjake 2175, në gjuhën turke 7808, si dhe në gjuhë të tjera botërore 7764, që do të thotë se në fondin e përgjithshëm të bibliotekës janë gjithsej 88290 ekzemplarë.

Mirëpo, duke e pasur parasysh pasurimin e fondeve gjatë vitit 2008, numri i përgjithshëm i ekzemplarëve libër ka kaluar 90-mijëshen. Po ashtu, në kuadër të pasurimit të fondeve me lloje të tjera të materialeve bibliotekare, Biblioteka Ndërkomunale e Prizrenit, posedon edhe një numër të CD, DVD, kasetave etj.

Kjo bibliotekë është e pasur edhe me tituj librash e dorëshkrimesh të vjetra. Një numër të konsiderueshëm të këtyre librave, biblioteka ka arritur t'i grumbullojë dhe t'i ruajë në

Tabela 1 – Të dhënat periodike të pasurimit të koleksioneve (1944 – 2007)



fondet e saja. Për shumë nga titujt e tjerë tashmë janë marrë informacion për vendndodhjen e tyre.

NUMRI I LEXUESVE DHE STRUKTURA E LEXUESVE

Numri i përdoruesve që marrin informacione apo shërbehen me koleksionet e kësaj biblioteke për çdo vit është në rritje, edhe pse në një qytet siç është Prizreni me një numër në rritje të popullsisë, kjo hapësirë e bibliotekës është shumë e vogël për t'i plotësuar kërkesat, duke pasur parasysh se këtë biblioteke e frekuentojnë të gjitha moshat e lexuesve.

Tabela 2 - Numri dhe struktura e lexuesve si dhe numri i njësive libër, që janë përdorur gjatë vitit 2007

	Nxënës	Studentë	Punëtorë	Bujq	Amvise	Të tjerë	Gjithsej
Nr. Lexuesve	3320	576	36	6	7	99	4044
Nr. lib. të lexuara	34081	6962	436	77	108	1082	42746

VEPRIMTARIA BOTUESE

Biblioteke Ndërkomunale e Prizrenit, veprimtarinë botuese e ka filluar në vitin 2004. Botimet janë të karakterit promovues por edhe kulturor e arsimor. Deri më tash biblioteka ka botuar 6 tituj, ndërsa prite që së shpejti të nxjerrë në nga botimi edhe dy tituj të rinj. Titujt e botuar deri më tani janë: *“Monografia e bibliotekës”, “Puhiza lirike I”, “Puhiza lirike II”, “Libra të Rrallë”, “Rrugëtim fjalësh”, “Ndize dritën e mendimit”*.

RRJETI I BIBLIOTEKAVE TË PRIZRENIT

Biblioteke Ndërkomunale e Prizrenit mbikëqyrë punën dhe aktivitetin e një sërë bibliotekave që janë të shtrira përreth rajonit të Prizrenit. Pra, në kuadër të mbikëqyrjes së proceseve të zhvillimit dhe menaxhimit, përfshihen: Biblioteke e Dragashit/Sharit - me bibliotekat e fshatrave: Brezne,

Bresan, Bellobrad, Brod, Krushevo; Biblioteke e Suharekës/Therandës - me bibliotekat e fshatrave: Nishor dhe Mushtisht; Biblioteke e Malishevës me bibliotekën në Kijevë; Biblioteke në Mamushë; Biblioteke në Gjonaj; Biblioteke në Zym, si dhe bibliotekat universitare dhe shkollore, të cilat janë në kuadër të qytetit të Prizrenit.

AKTIVITETET E BIBLIOTEKËS

Duke e vlerësuar rolin e bibliotekës në aspektin i misionit të saj informues,

edukativ dhe kulturor, biblioteka organizon shumë aktivitet për të përmbushur kërkesat dhe nevojat e përdoruesve, duke organizuar seminare të ndryshme me karakter bibliotekar, takime me shkrimtarë, promovime të librave, ligjërata me profesorë të ndryshëm vendorë dhe ndërkombëtar, trajnime për punëtorë të bibliotekave si dhe për arsimtarë të

shkollave të ndryshme, përcjellje të filmave dhe materialeve të ndryshme përmes CD-ve, DVD-ve, si dhe komentim të materialeve të shikuara, orë për mësim të gjuhëve të huaja, orë bashkëbisedimi me psikologë, mjekë etj.. Pra, të gjitha këto aktivitete biblioteka i organizon duke u bazuar në kërkesat dhe nevojat e punëtorëve të bibliotekës, si dhe të përdoruesve të të gjitha moshave.

KUSH NDIHMOI BIBLIOTEKËN

Biblioteke edhe pse nën mbikëqyrjen financiare të Ministrisë së Kulturës, nga e cila edhe financohet, për realizimin e projekteve të ndryshme apo edhe për pasurim të fondit bibliotekar, gjatë këtyre viteve të fundit është ndihmuar nga: Ambasada Amerikane nga e cila edhe vazhdon të ndihmohet, Ambasada Zvicerane, OSBE në Prizren, Fondacioni për Shoqëri të Hapur Sooros, UNHCR, OSI Budapest, KFOR-i turk, KFOR-i gjerman, BKUK; po ashtu edhe nga shumë dashamirë të librit, të cilët bibliotekës i dhuruan një numër të madh të librave apo edhe bibliotekat e tyre siç është rasti i z. Bedredin Isaja, i cili bibliotekës i dhuroi më shumë se 2050 libra, z. Yll Zajmi, i cili bibliotekës i dhuroi një numër të vlefshëm të titujve të vjetër dhe të rrallë etj.

Biblioteke e Suzi Çelebiut në Prizren (1513)



SHTATË VITE LEXIM NË BKUK

Kaluan shtatë vite studime, e kjo në memorien time kap momentet dhe kohën e shtatë ditëve të zakonshme, pra koha ikën dhe kalon shumë shpejt, por momentet më interesante për këtë mbetën kujtimet me njerëzit e veçantë dhe po ashtu me vendin jo të zakonshëm. Të gjitha këto vite studimi i kam kaluar dhe sfiduar me lexim, sepse leximi është formim së pari shpirtëror e pastaj intelektual. Shtatë vite lexim dhe përqendrim në institucionin e dijes, kulturës, BKUK, kjo për faktin se (Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës) disponon mbi 2 milionë ekzemplarë të materialeve bibliotekare, që do të thotë se vlerësohet ndër bibliotekat shumë të pasura me tituj materialesh fushash dhe llojesh të ndryshme.

Pra, shkaku i përqendrimit tim për shtatë vite lexim në BKUK është i shumëfishtë, por unë do t'i theksoj disa. Në fillim të vitit të parë të studimeve fillova të interesohem për një vend të përshtatshëm për lexim, një vend që të ofron qetësi dhe ngrohësi emocionale, ndërsa që qetësinë e ofron ambienti, ndërsa ngrohësinë stafi bibliotekar. Në fillim e kisha shumë të vështirë, sepse ishin kontaktet e para me njerëz që kurrë nuk i kisha njohur, ndërsa që dëshira për t'u bërë përdorues i BKUK-së ishte e madhe. Vullneti im për dije i tërhoqi para meje të gjitha barrierat. Anëtarësimi im në BKUK më solli rezultate të kënaqshme, meqë ambienti ishte i qetë dhe po ashtu literatura, si element esencial i studimeve, ishte në nivelin e kënaqshëm. Pra, BKUK ishte vendi ku mund të gjeje mundësinë e leximit dhe të kërkimit.

Kaloi viti i parë i studimeve dhe



ambientimi në BKUK e mori rolin e shtëpisë sime, kjo për faktin se me fillimin e vitit të dytë, me disa nga punonjësit e BKUK-së kisha krijuar afri për shkak të komunikimit me ta gjatë kërkimeve që bëja në bibliotekë. Një ditë nga BKUK mora edhe një motivim - të drejtën që një vit të plotë të shërbehem falas me të gjitha mundësitë që ka Biblioteka brenda. Pra, mora kartelën falas për një vit leximi dhe kjo më gëzoi.

Vitet ikin shumë shpejt, por momentet më të mira mbetën në kujtesën tonë, e kujtimet e mira japin dashuri. Janë këto kujtime të leximit në BKUK, të cilat sjellin pastaj dëshirën e shkrimit dhe dashurinë e kujtimit për çastet më të mira gjatë nxënies së dijeve. Ky shkrim për kujtimet e mia në BKUK, përveç rikthimit të kujtimeve të dikurshme, kujtime që shënojnë një kohë që përmbushin motivin për rrugëtimin

jo të lehtë drejt së ardhmes, është edhe një ndjenjë që i jep kujtimit emocion.

E gjithë kjo kohë leximi në BKUK është dëshira për të lidhur kohën në binomin e saj, pra kohën sinkronike, kohën e fillimit drejt formimit dituror dhe atij shpirtëror dhe kohën aktuale, diakronike tani si plotësim dhe përvetësim i njohjeve formuese. Bashkimi i kohëve nëpërmjet shkrimit ngjall forcë dhe vetëbesim, në ballafaqimin e jetës së njeriut në kohën tonë "moderne". Shtatë vite lexim, janë shtatë vite kujtimi e mba-mendjeje nëpër labirintet e dijeve me libra, si dhe miqësive me njerëz - bibliotekarë, të cilët të udhëzojnë në çdo çast në kërkimet nëpër skedarët, që përbëjnë çudinë e referencialitetit në versione të ndryshme, për të cilën shumë herët të duhet edhe durimi miqësor i bibliotekarëve referalë.

Fitim Veliu

PROMOVOHET KULTURA E KOSOVËS NË JORDANI

Jordani (Amman), 10-13 janar 2009

Ditët nga 10-13 janar 2009, mund të quhen "Ditët e Kosovës në Jordani", duke u bazuar në shtypin jordanëz, i cili përcolli dy ngjarje të mëdha kulturore: promovimin e "Antologjisë së poezisë bashkëkohore të Kosovës", hartuar dhe përkthyer nga Muhamed Mufaku, e cila u botua këto ditë arabisht në Amman, si dhe ekspozitën "Dorëshkrimeve arabe në Kosovë", projekt i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, e cila u hap dhe u promovua në dy universitete jordaneze.

Promovimi i "Antologjisë së poezisë bashkëkohore të Kosovës u bë më 10 janar 2009 në hapësirën e Shtëpisë Botuese "Azminah", drejtor i së cilës është shkrimtari jordanëz me reputacion në botën arabofone Iljaz Farkuh dhe në prani të dy poetëve të prezantuar në këtë Antologji: Sali Bashota dhe Basri Çapriqi.

Këtë Antologji e përgatiti prof. Muhamed Mufaku dhe përfshiu 17 poetë të Kosovës: Enver Gjerqeku, Din Mehmeti, Besim Bokshi, Muhamed Kërveshi, Fahredin Gunga, Azem Shkreli, Rrahman Dedaj, Ali Podrimja, Musa Ramadani, Ibrahim Kadriu, Ymer Shkreli, Eqrem Basha, Flora Brovina, Sabri Hamiti, Edi Shukriu, Sali Bashota dhe Basri Çapriqi.

Në promovim kanë marrë pjesë akademikë, shkrimtarë, përkthyes e gazetarë të Jordanisë. Promovimi është hapur nga shkrimtari Iljaz Farkuh, i cili ka përshëndetur këtë

ndërmarrje kulturore që po bëhet në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës në Kosovë, duke shprehur se kjo do të hapë perspektivë për njohje të mirë të kulturës bashkëkohore të Kosovës me botimin e veprave të tjera në vitet që vijojnë.

Kryetari i PEN Qendrës së Kosovës - Basri Çapriqi, ka folur për krijimtarinë letrare në Kosovë, duke u ndalur veçanërisht për zhvillimin e poezisë shqipe në situata dhe rrethana të caktuara kohore, si dhe për format e bashkëpunimit kulturor midis Kosovës dhe Jordanisë, duke marrë si shembull botimin e kësaj Antologjie.

Nga pala jordaneze, ka folur shkrimtari dhe përkthyesi i specializuar në Ballkan Ismail Abu Banadora, i cili ka veçuar rëndësinë e kësaj iniciative për të prezantuar sa më mirë Kosovën në aspektin kulturor, duke falënderuar punën shumëvjeçare të autorit Mufaku në promovimin e Kosovës në aspektin historik dhe në atë kulturor që krijon njohje reciproke.

Në këtë promovim ka folur edhe poeti i njohur jordanëz - Najef Abu Ubajt, duke theksuar vlerat origjinale që ka poezia kosovare e prezantuar në këtë Antologji.

Autori i Antologjisë M. Mufaku ka falënderuar botuesin për botimin e kësaj Antologjie, duke theksuar rolin e kulturës në ngritjen e urave midis popujve. Në fund, poetët jordanëz Hajtham Sarhan dhe Omar Halifa, kanë recituar disa nga vjershat e kësaj Antologjie që është pritur me interesim të madh nga të pranishmit.

* * *

Aktiviteti i dytë - i organizuar në Amman, më 11 janar 2009, ishte hapja e ekspozitës "Dorëshkrime arabe në Kosovë", e mbajtur në ambientet e Bibliotekës Universitare të Universitetit Al Al-Bajtit në veri të Ammanit.

Në ceremoninë solemne, ekspozitën e kanë përuruar rektori i këtij universiteti prof. Nabil Shavakfa dhe drejtori i BKUK-së prof. Sali Bashota. Në këtë ekspozitë është prezantuar Katologu në dy gjuhë shqip-arabisht, si dhe 50 ballina të dorëshkrimeve arabe në Kosovë, të cilat datojnë nga shekulli XIII dhe që kanë përmbajtje historike, gjuhësore, kulturore, fetare.

Me rastin e kësaj ekspozite, rektori prof. Shavakfa ka pritur mysafirët nga Kosova në një takim të veçantë, me ç'rast ka shprehur gatishmërinë për bashkëpunim të gjerë në shumë fusha me Universitetin e Prishtinës, Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, si dhe me institucione të tjera arsimore, kulturore, shkencore të Kosovës.

Më 12 janar 2009 e njëjta ekspozitë është hapur në Bibliotekën e Universitetit Filadelfia të Ammanit. Edhe këtu, ekspozita ka zgjuar një interesim të jashtëzakonshëm nga profesorë dhe studentë të këtij universiteti. Përfaqësuesit nga Kosova janë pritur nga rektori i këtij Universiteti, i cili ka treguar interesim për bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës.

Gjatë këtyre ditëve qëndrimi, gazetat e përditshme të Jordanisë: a-Rai, Addustur, al-Gad, kanë përcjellë me interesim këto aktivitete.

DREJTORI I BIBLIOTEKËS KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE TË MAQEDONISË NË BKUK

Prishtinë, 12 shkurt 2009

Drejtori i BKUK-së dr. Sali Bashota, më 12 shkurt 2009, priti në një vizitë zyrtare Drejtorin e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Maqedonisë - z. Mile Bosheski me bashkëpunëtorët e tij.

Në takimin e tyre është biseduar për organizimin e veprimtarive të ndryshme me karakter trajnues për stafin e dy bibliotekave, pastaj për përmirësimin e shërbimeve bibliotekare sipas standardeve më të reja ndërkombëtare, si dhe për

shërbimet e veçanta në biblioteka nacionale. siç janë: katalogu elektronik, qarkullimi, huazimi ndër-bibliotekar, shërbimi i konservimit dhe i restaurimit të librit dhe sidomos krijimi i Bibliotekave Digjitale.

Gjithashtu, në këtë takim është biseduar edhe për sistemet më të avancuara bibliotekare që i posedon BKUK, siç janë: sistemi i sigurisë së librit (sistemi bibliotekar RFID), sistemi i transportimit të librave përmes teknologjisë më moderne, me ç'rast delegacioni maqedonas mori pjesë në prezantimin praktik

të këtyre sistemeve, të cilat janë në funksion që disa vite në BKUK.

Kohë më parë Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës dhe Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Maqedonisë kanë filluar bashkëpunimin në fushën e bibliografisë. Bazë e këtij bashkëpunimi është projekti i BKUK-së: "Libri shqip: Bibliografia retrospektive 1944-1984", me ç'rast Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Maqedonisë ka ofruar një ndihmesë të madhe në sigurimin e disa botimeve që kanë të bëjnë me këtë projekt.

BKUK NË SHËRBIM TË BIBLIOTEKAVE SHKOLLORE

Ratkofo (Rahovec), 26 janar 2009

Departamenti për Arsimimin Bibliotekar i BKUK-së vijon të ofrojë ndihmë në përpunimin, si dhe në pasurimin e koleksioneve edhe të bibliotekave shkollore.

Më 26 janar të këtij viti, me rastin e përrurimit të bibliotekës së shkollës së mesme "Xhelal Hajda" në Ratkofo (Rahovec), nga BKUK, përkatësisht

Departamenti për Arsimim Bibliotekar janë dhuruar 134 tituj të librave. Gjatë kësaj vizite janë vlerësuar mundësitë për pasurimin edhe më tej të koleksioneve të kësaj biblioteke dhe për mundësitë e aftësimin të stafit për përpunimin dhe sistematizimin e koleksioneve.

Kjo ndihmë e BKUK-së është vlerësuar nga nënkryetari i komunës së Rahovecit, z. Xhevdet Duraku, si dhe

drejtori i kësaj shkolle, z. Ibrahim Ukaj, të cilët kanë ofruar përkushtimin e tyre për të ndihmuar në pajisjen e kësaj biblioteke me inventarë dhe kompjuterë.

Carrallukë (Malishevë), 11 shkurt 2009

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës - Departamenti për Arsimim Bibliotekar, i ka dhuruar 268 tituj të librave shkollës fillore "Hilmi Hoti" të Carrallukës (Malishevë) dhe po ashtu ka ofruar ndihmë profesionale në përpunimin dhe klasifikimin e koleksioneve bibliotekare. Kjo shkollë dhe biblioteka e saj, gjatë luftës në Kosovë ishte djegur. Në objektin e ri të shkollës, është krijuar hapësirë e veçantë për bibliotekën e shkollës, fondi i së cilës është duke u pasuruar me tituj të rinj.

Drejtori i shkollës, Ibrahim Ukaj, ka falënderuar BKUK-në për ndihmë në pasurimin dhe përpunimin e koleksioneve.

Ramize Bajraktari



Përrurimi i bibliotekës së shkollës së mesme "Xhelal Hajda" në Ratkofo

AMBASADORI I REPUBLIKËS SË KROACISË NË PRISHTINË VIZITON BKUK-në

Prishtinë, 17 mars 2009

Drejtori i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës dr. Sali Bashota, më 17 mars 2009, ka pritur në një vizitë zyrtare Ambasadorin e Republikës së Kroacisë në Prishtinë - Dr. Zlatko Kramaric me bashkëpunëtorët e tij. Gjatë këtij takimi drejtori i BKUK-së dr. Bashota i ka shprehur falënderime për kontributin që ka dhënë dhe jep Kroacia në Kosovë në shumë drejtime, duke kërkuar që të vijohet një bashkëpunim në fushën e kulturës, sidomos në nivel të Bibliotekave Kombëtare të të dy shteteve, nëpërmjet projekteve konkrete.

Ambasadori i Kroacisë ka shprehur gatishmërinë e bashkëpunimit kulturor dhe arsimor midis institucioneve të këtyre dy shteteve, duke inkurajuar faktin se bashkëpunimi në këto fusha



Dr. Sali Bashota dhe Dr. Zlatko Kramaric Ambasador i Republikës së Kroacisë në Prishtinë

është me mjaft interes edhe për vetë shtetin kroat, pasi që popullsia e tretë më e madhe në shtetin kroat janë shqiptarët, dhe se tanimë është duke u punuar rreth kontakteve në mes të dy ministrive të Arsimit të dy vendeve.

Ideja për krijimin apo hapjen e një Këndi të Librit të Kosovës në një të ardhme në Bibliotekën Kombëtare

dhe Universitare të Kroacisë është mbështetur fuqishëm nga Ambasadori i Kroacisë në Prishtinë.

Në fund të këtij takimi, është mirëpritur një bashkëpunim konkret në mes Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës dhe Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kroacisë.

DREJTORI I BKUK-së NË BIBLIOTEKËN QENDRORE TË CYRIHUT NË ZVICËR

Cyrih, 3-6 mars 2009

Drejtori i BKUK, Dr. Sali Bashota me bashkëpunëtorët e tij, nga 3-6 mars 2009, kanë pasur një vizitë zyrtare në Bibliotekën Qendrore të Cyrihut dhe në Bibliotekën Unversitare të Institutit Federal Zviceran për Teknologji ETH.

Bashkëpunimit midis Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës me Bibliotekën Qendrore të Cyrihut është përqendruar në disa fusha, e veçmas në sistemin e automatizuar bibliotekar Aleph 500, duke e

ditur faktin se këto dy Biblioteka kanë të njëjtin program dhe bashkëpunimi me Bibliotekën Qendrore të Cyrihut në këtë drejtim është mjaft i mirëseardhur për BKUK-në. Gjatë kësaj vizite është bërë demonstrimi praktik i shumë moduleve të administrimit të programit, të pasurimit, katalogimit, qarkullimit, nga stafi profesional i Bibliotekës Qendrore të Cyrihut dhe Bibliotekës Universitare të Institutit ETH.

Në takimin e Drejtorit të BKUK-së - Dr. Sali Bashota me zv. drejtorin - Christoph Meyer, është biseduar për

prioritetet dhe planet e veprimit në realizimin e projekteve konkrete midis këtyre dy institucioneve. Puna do të fillojë në projektin e përbashkët "Scopes 2009-2012", që përfshin bashkëpunimin shkencor në mes Evropës Lindore dhe Zvicrës.

Gjithashtu delegacioni nga BKUK ka vizituar edhe Bibliotekën e Institutit Federal Zviceran për Teknologji ETH, me ç'rast kanë pasur takime me drejtorin Dr. Wolfram Neubauer, ku është biseduar për mundësinë e bashkëpunimit në shumë projekte.

Përgatiti: Diana TOPALLI

DORËSHKRIMET ARABE NË KOSOVËS: KATALOG. PRISHTINË: BKUK 2008, 61 F.

Nevojën e kamotshme të lexuesit që të ketë një pasqyre mbi dorëshkrimet arabe të cilat gjinden të shpërndara nëpër bibliotekat personale apo institucione fetare e arsimore, e ka plotësuar në njëfarë mase botimi nga BKUK, i një katalogu me këto dorëshkrime, i hartuar nga Ismail Ahmeti, Nehat Krasniqi dhe Qemajl Morina, i titulluar: “*Dorëshkrimet Arabe në Kosovës*”. Ky katalog është me interes të veçantë, sepse synon t’i paraqesë opinionit shqiptar si dhe atij arab, vlerat më të ndritura të historisë së kulturës dhe të qytetërimit të përbashkët që kanë krijuar këta popuj gjatë historisë. Koha e datimit të këtyre dorëshkrimeve, përfshinë periudhën që nga shekulli XIII e gjerë në shekullin XVIII.

Katalogu “*Dorëshkrimet Arabe në Kosovës*” ka 61 faqe dhe është i përbërë prej 50 njësive me shtrirje tematike e kronologjike, si: Hadhith dhe sire (biografi); Fikh dhe jurisprudencë islame; Akaid, filozofi, tesavuf; Gjuhësi dhe letërsi arabe; shkenca shoqërore dhe Shkenca natyrore dhe mjekësi. Çdo dorëshkrim i prezantuar në këtë katalog, përmban të dhëna të shkurtra bibliografike: emrin e autorit, titullin e veprës, emrin e kopjuesit dhe vitin e kopjimit. Me një fjalë, katalogu është i pajisur me aparaturnë elementare shkencore dhe përfill parimet e organizimit metodologjik shkencor të një katalogu të mirëfilltë. Vlera e këtij katalogu, qëndron edhe në faktin se të gjithë titujt e dorëshkrimeve të prezantuara, përmbi përshkrimin bibliografik, disponojnë edhe me nga një faqe të skanuar të dorëshkrimit, e cila i jep kuptim më të plotë katalogut.

**CENSORI I PËRSOSUR: OSE DORACAK PRAKTIK I LUFTËS KUNDËR LIBRAVE TË DËMSHËM DHE AUTORËVE TË TYRE. PRISHTINË: ERA 2002, 260 F.**

Ilirologu dhe një nga studiuesit më të njohur të historisë dhe fatit të librit, arbëreshi i Zarës Aleksandër Stipçeviq, prezanton para lexuesit librin e radhës mbi censurën, por kësaj radhe si masë preventive kundër librave të dëmshëm dhe autorëve të tyre. Libri i studiuesit A. Stipçeviq: “*Censori i përsosur ose doracak praktik i luftës kundër librave të dëmshëm dhe autorëve të tyre*”, është përkthyer nga gjuha kroate në atë shqipe, me mjeshtëri nga publicisti Augustin Palokaj. Në fakt, ky libër, i hartuar në formë të doracakut, përmbledh udhëzime e shembuj të shumtë në lidhje me atë që çka duhet të bëjë pushteti shtetëror për ta parandaluar keqpërdorimin e fjalës së shkruar nga elementet e pandërgjegjshëm dhe profiterët e ndryshëm. Autori i përshkruan masat sistematike, të cilat pushteti, në periudha të ndryshme historike, i ka ndërmarrë për pengimin e librave të dëmshëm, sisteme të cilat shpesh kanë qenë aq efikase, saqë ka qenë e pamundur në treg të paraqitet ndonjë libër, i cili te lexuesi i ardhshëm do të ndikonte negativisht.

Në këtë studim një rëndësi e veçantë i kushtohet kontrollit të punës së shtypshkronjave dhe botuesve; obligimi i regjistrimit të botuesve, gazetës, revistës etj., pranë organeve kompetente; dënimi i botuesve dhe redaktorëve të padëgjueshëm; ciklostilit dhe fotokopjimit si mjete për keqpërdorimin dhe shumëzimin e librave; roli dhe përgjegjësia e redaktorit si censor; roli dhe përgjegjësia a recensentit si censor. Autori ofron edhe udhëzime se si duhet të veprohet me librat e dëmshëm, ku në mesin e masave që duhet ndërmarrë, nëse libri i tillë arrin të botohet, përmendet: spastrimi dhe përmirësimi i librave, përmirësimi i librave nga vetë autori, nga censura, spastrimi i librave gjatë përkthimit, pengimi i shpërndarjes dhe leximit të librave të dëmshëm e deri te asgjësimi i librave të dëmshëm. Në kuadër të kësaj, potencohet edhe roli i bibliotekave publike në luftën kundër librave të dëmshëm.

Libri, gjithsej ka 260 faqe të konceptuara në katër kapituj dhe me nëntituj të hartuar sipas tematikave përkatëse.

GJON BERISHA

